

Të dhënat kryesore

Raiffeisen Bank Kosovo sh.a.			
Vlerat monetare janë në milionë €	2012	2011	Ndryshimi
Pasqyra e të ardhurave	1/1 – 31/12	1/1 – 31/12	
Të ardhurat neto nga interesi pas provizionimit	32.6	32.5	0.4%
Të ardhurat neto nga komisionet	7.8	7.8	-0.3%
Të ardhurat nga këmbimi valutor, neto	0.1	0.0	680.2%
Vlerësimi neto nga instrumentet financiare të bartura me vlerë të tregut, të vlefshme për shitje	(0.6)	(0.5)	6.9%
Vlerësimi neto i investimeve në degët vartëse	0.5	0.1	494.0%
Të ardhurat tjera operative	0.1	0.2	-63.1%
Shpenzimet operative	(26.4)	(26.3)	0.3%
Fitimi para tatimit	14.2	13.8	2.9%
Fitimi neto për vitin	12.6	12.4	1.9%
Fitimi për aksion	N/A	N/A	N/A
Bilanci i gjendjes			
Huatë për bankat	46.1	85.9	-46.3%
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	401.1	402.1	-0.3%
Kreditë tjera	20.9	30.9	-32.5%
Depozitat dhe huatë nga bankat	4.2	12.7	-66.8%
Depozitat nga klientët	513.9	557.3	-7.8%
Kapitali (duke përfshirë fitimin e mbajtur)	99.2	99.1	0.2%
Totali i bilancit të gjendjes	628.5	682.8	-7.9%
Informacione sipas rregullave lokale*			
Mjetet e rrezikuara B1 duke përfshirë riskun e tregut	490.5	453.9	8.1%
Totali i fondeve vetanake	67.1	92.2	-27.2%
Kërkesat e totalit të fondeve vetanake	58.9	54.5	8.1%
Koeficienti i mbulueshmërisë së fondeve vetanake	14.0%	69.2%	-55.2 PP
Koeficienti i kapitalit të klasit të parë (Tier 1), sipas librave	12.7%	19.3%	-6.6 PP
Koeficienti i kapitalit të klasit të parë (Tier 1)	12.7%	19.3%	-6.6 PP
Koeficienti i fondeve vetanake	13.7%	20.3%	-6.6 PP
Performanca			
Kthimi në kapital (ROE) para tatimit	15.8%	15.4%	0.1 PP
Kthimi në kapital ROE) pas tatimit	14.1%	14.1%	-
Raporti i shpenzimeve / të ardhurave	58.3%	57.3%	1 PP
Kthimi në pasuri (ROA) para tatimit	2.2%	2.0%	0.2 PP
Koeficienti i rrezikut kreditor neto (mesatarja e mjeteve të rrezikuara B2 sipas librave)	1.1%	1.3%	-0.2 PP
Koeficienti i rrezikut / fitimit	12.7%	15.2%	-2.5 PP
Burime			
Numri i punonjësve	675	708	-4.7%
Numri i degëve dhe nëndegëve	50	52	-3.8%

* Informacionet sipas rregullave lokale për vitin 2012 janë përgatitur në pajtim me rregulloret e reja bankare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të cilat janë publikuar në vitin 2012.

Përmbajtja

Raport nga Bordi Mbikëqyrës	4
Raport nga Bordi Menaxhues	5
Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë	6
Struktura organizative	7
Vizioni dhe misioni	8
Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International	9
Mjedisi makroekonomik në Kosovë	10
Shkurtimisht mbi Bankën Raiffeisen në Kosovë	12
Thesari	17
Korporatat	18
Afarizmi bankar me korporata	18
Produktet për korporata	18
Ndërmarrjet e vogla	19
Biznesi retail	20
Mikrobizneset	20
Individët	20
Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve	20
Kanalet e distribuimit	21
Shërbimi për klientë	21
Menaxhimi i kredive dhe riskut	22
Operacionet	22
Teknologjia informative dhe e komunikimit	24
Trajnimi dhe menaxhimi i personelit	24
<hr/>	
Pasqyrat financiare	26
Fjalorth i Raiffeisen	66
RBI Group në Evropë	67
Adresat dhe kontaktet	68

Raport nga Bordi Mbikëqyrës

Zonja dhe zotërinj,

Nga këndvështrimi i përgjithshëm ekonomik, viti 2012 ka qenë një vit sfidues edhe në Eurozonë edhe në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), për arsye plotësisht të ndryshme. Pas krizës së vazhdueshme me borxhe shtetërore, Eurozona rrëshqiti në një krizë të thellë sistemike. Kjo krizë u karakterizua me mosmarrëveshje politike lidhur me mënyrat për tejkalimin e ngarkesës së krijuar nga borxhet dhe me trazira sociale të cilat u zhvilluan në disa shtete evropiane. Paafësia e elitës politike, qoftë në nivel shtetëror qoftë në atë evropian, për t'ua komunikuar vendimet e veta opinionit publik në mënyrë transparente dhe të kuptueshme i kontribui edhe më tej kësaj krize.

Edhe një pjesë e EQL vuajti pasojat e krizës në zonën e euros, gjë që u manifestua, për shembull, me rënien e eksporteve si rrjedhojë e rënies së kërkesës në shtetet perëndimore. Edhe pse shtetet në EQL gjithashtu pësuan rënie të BPV-së reale, ato megjithatë mbeten dukshëm mbi mesataren e shënuar në Eurozonë. Megjithatë, me fare pak përjashtime, shtetet e rajonit të EQL-së i kanë kryer detyrat e shtëpisë si duhet: ato janë shumë më pak të varura nga financimi i jashtëm, për shkak të balancit relativisht të ulët të deficitit në pagesa; produktiviteti i tyre është përmirësuar falë rritjes modeste të pagave dhe, me përjashtim të Hungarisë, ky rajon ka borxh konsiderueshëm më të ulët se sa Evropa perëndimore. Megjithatë, rajoni vazhdon të përfitojë nga proceset që kanë për qëllim arrijten e një standardi të caktuar zhvillimor, gjë që mbetet motori i zhvillimit ekonomik në to e rrjedhimisht edhe zhvillimit të Evropës në tërësi.



Përkundër përballjes me një vit që u dominua nga rënia ekonomike e përsëritur dhe me rregullore më të rrepta sa i përket trajtimit të kapitalit, RBI Group mund të jetë krenare me profitin e arritur prej mbi 1 miliardë euro para taksave. Megjithatë, më duhet të përmend disa efekte të rëndësishme dhe të papërsëritshme të cilat u shfaqën gjatë tremujorit të parë: mes tjerash, ne kemi shitur bono tejet cilësore për të arritur normën e kapitalit që kërkohet nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA). Përderisa kjo shitje neve na kushtoi me një pjesë të të ardhurave neto nga interesi në tremujorët vijues, ajo gjithashtu rezultoi me fitime të dukshme neto. Jam tejet i kënaqur që kemi arritur ta plotësojmë normën më të lartë të kapitalit, duke pasur koeficientin e kapitalit të klasit të parë dukshëm mbi 10 për qind, gjë që neve na bën edhe më të fortë në përballje me kushtet e pafavorshme ekonomike.

Sa i përket Bankës Raiffeisen në Kosovë, jam i lumtur që mund të deklaroj se ajo ka pasur një tjetër vit tejet të kënaqshëm edhe sa i përket profitit por edhe treguesve të tjerë kyç të performancës. Me një BPV (Bruto Prodhimi Vendor) prej 3 për qind, që ishte dukshëm më e lartë se BPV e vendeve të tjera të rajonit, Kosova sërisht arriti të ketë rritjen më të lartë të BPV-së në Evropën Qendrore dhe Lindore. Sektori bankar në Kosovë ka mbetur profitabil duke kontribuar kështu në stabilitetin financiar të vendit. Edhe Banka Raiffeisen në Kosovë ka luajtur një rol të rëndësishëm në tregun lokal me performancën e saj të suksesshme. Në vitin 2012, vazhdoi ta mbajë pozitën e saj si banka e dytë më e madhe dhe në të njëjtën kohë vazhdoi të jetë banka me kapitalin më të madh në Kosovë. Rritja e kredive me kujdes për të gjitha segmentet e klientëve, zhvillimi i shërbimeve të fundit elektronike bankare dhe shërbimet për klientë ishin prioritetet kryesore të Bankës Raiffeisen në Kosovë.

Do të dëshiroja ta falënderoj Bordin Menaxhues dhe të gjithë punonjësit për përkushtimin dhe dedikimin e tyre të vazhdueshëm. Po ashtu i falënderoj edhe të gjithë klientët për bashkëpunimin dhe besimin e tyre në Bankën Raiffeisen në Kosovë.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës,

Helmut Breit, Kryesues

Raport nga Bordi Menaxhues

Viti 2012 ishte vit shumë i mirë për Bankën Raiffeisen në Kosovë. Mjedisi makroekonomik i vendit ishte më i favorshëm se sa mjediset përkatëse të shumë vendeve tjera në Evropën juglindore ndërsa rritja mesatare e Bruto Prodhimi Vendor i Kosovës ishte 3%. Kjo i ndihmoi Bankës në arritjen e rezultateve pozitive në raport me një sërë treguesish kryesorë të performansës për vitin 2012.

Përkundër treguesve pozitivë ekonomik në Kosovë, ne gjatë vitit 2012 kemi pasur një qasje të kujdesshme sa i përket dhënies së kredive në të gjitha segmentet e klientëve dhe portfolio jonë kreditore e përgjithshme ka mbetur e barabartë me vëllimin e regjistruar në fund të vitit 2011. Kjo qasje e kujdesshme është pasqyruar edhe në cilësinë e shkëlqyeshme të punës sonë me kredi, segment ky në të cilin ne kemi shënuar rënie sa u përket kredive të këqija ndërsa është shënuar rritja më e vogël e rezervave për mbulimin e humbjeve nga kreditë gjatë këtyre viteve të fundit, prej 4.6 milionë euro.


Gjatë vitit 2012, kemi pasur mbi 500 milionë euro depozita nga klientët dhe kjo qartë demonstroi se klientët i besojnë Bankës sonë dhe e konfirmon se ata janë të kënaqur me shërbimet tona në degë dhe rrjet të shpërndarjes.

Një prioritet i lartë i vitit 2012 për ne ishte zhvillimi i shërbimeve bankare elektronike, siç janë bankomatet, терминаlet e pikave të shitjes dhe shërbimet bankare përmes internetit dhe telefonit. Ne kemi përmirësuar funksionalitetin, përballueshmërinë dhe qasjen në këto shërbime nga klientët tonë dhe kemi shtuar dukshëm shfrytëzimin e këtyre shërbimeve nga ta. Zhvillimi i mëtejshëm i këtyre shërbimeve do të mbetet prioritet i lartë për vitin 2013, si pjesë e synimit tonë për t'i bërë shërbimet bankare më të qasshme në tërë vendin dhe gjatë tërë kohës.

Përmirësimi i shërbimeve për klientë ishte një nga prioritetet tjera të larta për vitin 2012 dhe zhvillimet tona në këtë fushë nuk janë fokusuar vetëm në klientët që marrin shërbime në degët tona por edhe në proceset dhe procedurat tona të brendshme. Fokusimi ynë në këtë fushë ishte prioritet i lartë dhe pjesë e synimit tonë strategjik për të ofruar shërbimet më të mira në Kosovë dhe ne do të vazhdojmë të investojmë në këtë sferë të funksionimit tonë. Për të na ndihmuar në arritjen e këtij synimi, ne e kemi angazhuar një kompani që njihet botërisht për ekspertizën e vet në fushën e hulumtimit të tregut, nga e cila kemi kërkuar që ta kryejë një anketim të thukhtë të klientëve tanë, në mënyrë që ne të mund t'i kuptojmë nevojat, preferencat dhe gjërat që klientëve nuk u pëlqejnë lidhur me një sërë çështjesh, siç janë produktet tona, çmimet tona, rrjeti jonë i shpërndarjes dhe imazhi i brendit tonë. Këto të gjetura do të përbëjnë bazën e një programi të përqendruar tek klientët që do të jetësohet gjatë vitit 2013 dhe më tej.

Përfundimisht, në emër të Bordit Menaxhues, më lejon të falënderoj të gjithë punonjësit tanë për arritjen e rezultateve të shkëlqyeshme edhe gjatë këtij viti. Kjo nuk do të ishte e mundshme pa dijen, shkathtësitë, përkushtimin, besnikërinë dhe dedikimin e tyre dhe janë në fakt fuqia dhe aftësitë e tyre që më japin besim të plotë se edhe viti 2013 do të jetë një vit i suksesshëm.

Në emër të Bordit Menaxhues,



Robert Wright, Kryesues



Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Robert Wright

Kryesues i Bordit
Menaxhues



Shukri Mustafa

Anëtar i Bordit
Menaxhues



Iliriana Toçi

Anëtare e Bordit
Menaxhues




Johannes Riepl

Anëtar i Bordit
Menaxhues

Struktura organizative e Bankës Raiffeisen në Kosovë

Deri më 31 dhjetor 2012



Vizioni dhe misioni i Bankës Raiffeisen në Kosovë

Vizioni

Të jetë banka kryesore dhe universale në Kosovë.

Misioni

Të zhvillojë marrëdhënie afatgjata me klientë duke ju ofruar një gamë të gjerë të produkteve konkurruese dhe shërbime të një standardi të lartë.

Të jetë punëdhënësi më i mirë.

Shkurtimisht mbi Raiffeisen Bank International

Bankë udhëheqëse në Evropën Qendrore dhe Lindore, përfshirë Austrinë

Banka Raiffeisen në Kosovë është degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI), e cila e konsideron Evropën Qendrore dhe Lindore (përfshirë Austrinë) si tregun e vet. Për më shumë se 25 vite, RBI ka vepruar në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL), në të cilin sot ka një rrjet të fuqishëm të bankave, kompanive kreditore dhe kompanive që ofrojnë shërbime të specializuara financiare në 17 tregje të ndryshme, e të cilat funksionojnë si vartëse të saj. Si bankë universale, RBI konsiderohet një nga bankat udhëheqëse të këtij rajoni. Roli i fuqishëm që kjo bankë luan përkrhet nga brendi Raiffeisen, i cili është një nga brendet më të njohura në rajon. Me kalimin e kohës, RBI është shndërruar në një grup bankar tërësisht i integruar në afarizmin bankar me korporata dhe shitje me pakicë në EQL. Kjo bankë gëzon jo vetëm qasje të mirë tek klientët e vegjël dhe korporatat por edhe ofron një spektër gjithëpërfshirës produktesh. Në fund të vitit 2012, rreth 60,000 punonjës tanë i kanë shërbyer rreth 14.2 milionë klientë në rreth 3.100 pika në tërë EQL-në.

Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore investive dhe korporative. Ajo kryesisht u shërben klientëve austriakë, por edhe klientëve ndërkombëtarë dhe korporatave shumëkombëshe që veprojnë në EQL. Për më tepër, RBI është e përfaqësuar në qendrat financiare botërore dhe ka zyra përfaqësuese dhe degë në Azi. Në përgjithësi, RBI punëson rreth 60.000 punonjës dhe posedon pasuri me vlerë prej rreth 136 miliardë euro.

RBI ka banka vartëse në tregjet vijuese të EQL:

• Shqipëri	Raiffeisen Bank Sh.a.
• Bjellorusi	Priorbank JSC
• Bosnjë dhe Hercegovinë	Raiffeisen Bank d.d. Bosna i Hercegovina
• Bullgari	Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
• Kroaci	Raiffeisenbank Austria d.d.
• Republika Çeke	Raiffeisenbank a.s.
• Hungari	Raiffeisen Bank Zrt.
• Kosovë	Raiffeisen Bank Kosovo sh.a.
• Poloni	Raiffeisen Bank Polska S.A.
• Rumani	Raiffeisen Bank S.A.
• Rusi	ZAO Raiffeisenbank
• Serbi	Raiffeisen banka a.d.
• Sllovaki	Tatra banka, a.s.
• Slloveni	Raiffeisen Banka d.d.
• Ukrainë	Raiffeisen Bank Aval JSC

Si kompani amë e këtyre bankave, RBI në të shumtën e rasteve zotëron gati 100 për qind të aksioneve të tyre.

Zhvillimi i RBI

RBI është themeluar në tetor të vitit 2010 pas bashkimit të Raiffeisen International me njësitë kryesore afariste të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB). Pozita e RBI-së si një nga bankat udhëheqëse të EQL-së (përfshirë Austrinë) u përforcua edhe më tej pas këtij bashkimi. RBI është e regjistruar në bursën e Vjenës që nga 25 prilli 2005 (deri më 12 tetor 2010 si Raiffeisen International). Ajo gjithashtu përfaqësohet në disa indekse kombëtare dhe ndërkombëtare si ATX dhe EURO STOXX Banks. RZB ka mbetur aksionari kryesor pas bashkimit në fjalë, duke i zotëruar rreth 78.5 për qind të aksioneve. Pjesa e mbetur e aksioneve (21.5 për qind) janë në shitje të lirë.

RZB është formuar në vitin 1927 dhe është regjistruar si "Genossenschaftliche Zentralbank" (GZB). Raiffeisen së pari u kyç në Evropën Qendrore dhe Lindore në vitin e largët 1987, kur e themeloi bankën e parë vartëse të saj në Hungari. Që nga ajo kohë janë themeluar edhe disa kompani vartëse; nga viti 2000 e më tej, zgjerimi i Raiffeisen në vendet e EQL është arritur kryesisht përmes blerjes së bankave ekzistuese të cilat kombinoheshin në holdingun i cili prej vitit 2003 deri në tetor të vitit 2010 funksiononte nën emrin Raiffeisen International. Raiffeisen International u regjistrua në bursë në prill të vitit 2005, me qëllim të financimit të rritjes së vet në mënyrën më efikase të mundshme. Më pas, RBI u themelua në vitin 2010 përmes bashkimit të Raiffeisen International me fushat kryesore të afarizmit të RZB.

Për më shumë informata, ju lutemi t'i qaseni faqeve www.rbinternational.com dhe www.rzb.at.

Mjedisi makroekonomik në Kosovë

Shënim: Informatat në këtë kapitull bazohen në materiale të marra nga Banka Qendrore e Kosovës, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Ministria e Financave.

Zhvillimet politike

Grupi Ndërkombëtar Drejtues dhe pëlqimin për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës më 10 shtator 2012, duke e mbyllur kësaj Zyrën Ndërkombëtare Civile, e cila luante rolin e autoritetit përfundimtar sa i përket interpretimit të Planit të Ahtisaarit. Pas kësaj, në tetor të vitit 2012, Bashkimi Evropian konfirmoi në Studimin e Fizibilitetit të cilin e nxori, se Kosova nuk kishte kurrfarë pengese ligjore dhe se ishte e gatshme për të nisur negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (pas jetësimit të katër politikave afatshkurtra). Njëkohësisht, Komisioni Evropian (KE) hapi procesin e Dialogut për Liberalizimin e Vizave.

Në fund të vitit 2012, 96 shtete të botës kishin njohur Kosovën si shtet të pavarur, përfshirë edhe 22 shtete të Bashkimit Evropian. Bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë kanë vazhduar ndërsa kryeministrat e të dyja shteteve u takuan në tetor të vitit 2012. Bisedimet janë duke u ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe pritet të vazhdojnë në vitin 2013. Si rezultat i këtyre bisedimeve, në fund të vitit 2012 është arritur pajtimi për fillimin e implementimit të Menaxhimit të Integruar të Kufijve mes dy vendeve.

Zhvillimet ekonomike

Integrimi i Kosovës në institucione ndërkombëtare ka vazhduar edhe në vitin 2012 me anëtarësimin e saj si shtet-anëtar i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Fondi Monetar Ndërkombëtar i ka lejuar Kosovës një kredi prej 107 milionë eurosh në formë të marrëveshjes 'stand-by'.

Në vitin 2012, për herë të parë qeveria ka emetuar publikisht bono thesari, përmes bankave të licencuara komerciale në Kosovë. Gjatë këtij viti janë mbajtur 14 licitacione, secili për bono me vlerë prej 10 milionë eurosh për një periudhë prej 13 javësh. Yields ranë nga 3.5 për qind fillimisht në 1.08 për qind nga fundi i vitit.

Procesi i privatizimit ka vazhduar me shitjen e distribucionit të energjisë elektrike tek kompania turke Limak, që ishte ofertuesi më i lartë me 26 milionë euro. Ndërkohë, privatizimi i kompanisë së telekomunikacionit, i cili nuk arriti të përfundojë në vitin 2012 është duke u finalizuar dhe fituesi i këtij procesi do të përzgjidhet në gjysmën e parë të vitit 2013. Privatizimi i qendrës së skijimit në Brezovicë ende nuk është realizuar dhe pritet të trajtohet po ashtu gjatë vitit 2013.



Spektori financiar mbetet fitimprurës dhe ofron stabilitet financiar. Duke qenë burimi kryesor i financimit, bankat komerciale kanë vazhduar praktikën e tyre të huadhënies së kujdesshme, ndërsa rritja e depozitave të klientëve është dëshmi e besimit që ata kanë tek bankat. Ndërkohë, bankat kanë riadresuar çështjen e normave të larta të interesit në kontekst të mjedisit afarist, duke marrë parasysh faktorët siç janë roli i ekonomisë joformale dhe proceset joefektive gjyqësore. Sidoqoftë, tregu nuk e ka humbur potencialin për të joshur banka të reja, gjë që dëshmohet me ardhjen e bankës turke İŞ Bankası rishtas, me çka numri i bankave është ngritur në nëntë.

Kosova ka zënë vendin e 98të në publikimin e fundit të Bankës Botërore mbi të bërit biznes, duke avancuar kësaj për 28 vende në krahasim me vitin e kaluar dhe duke fituar reputacionin si një nga vendet më reformuese të Evropës qendrore dhe juglindore.

Prodhimi

Rritja e përgjithshme vjetore e ekonomisë së Kosovës gjatë vitit 2012 ishte 3 për qind, ndërsa edhe për vitin 2013 pritet një temp i ngjashëm i rritjes. Kjo bën që Kosova të jetë ekonomia me rritjen më të shpejtë në Evropën juglindore. Shpenzimet publike dhe konsumi privat janë faktorët që më së shumti i kontribuojnë këtij zhvillimi. Kapitali fiks bruto kontribuon rreth një të tretën e BPV-së. Megjithatë, llogaritë aktuale të vendit dëshmojnë se importet janë më të larta se eksportet (me faktor gjegjës prej rreth 7) dhe se ekonomia varet në masë të gjerë nga donacionet dhe remitancat. Norma e inflacionit për këtë vit ishte stabile, rreth 2.2 për qind.

Norma e lartë e papunësisë dhe jetesa e një pjese të madhe të popullatës nën nivelin e varfërisë vazhdojnë të mbesin kërcënime sociale që duhet të adresohen.



Sektori bankar në Kosovë

Sektori bankar vlen rreth 2.8 miliardë euro, që është baras me gati 61 për qind të bruto prodhimit vendor, ndërsa që gjatë vitit të kaluar është rritur me rreth 6.5 për qind. Gjatë kësaj periudhe, kreditë janë shtuar me 4 për qind ndërsa depozitat me 8 për qind. Bankat kanë shënuar profit të përgjithshëm prej 44.5 milionë euro, që është për 6 për qind më i lartë se sa në vitin 2011. Të dhënat për tremujorin e tretë paraqesin normë të adekuacisë së kapitalit prej 18 për qind, ndërsa kreditë e këqija përbëjnë 7 për qind të të gjitha kredive të lëshuara.



Profitabiliteti afarist për bankat është përgjysmuar në krahasim me vitin e kaluar, edhe sa i përket Kthimit në pasuri, i cili është 0.7 për qind, edhe sa i përket Kthimit në kapital, që tani është 14.3 për qind.

Shkurtimisht mbi Bankën Raiffeisen në Kosovë

Shënim: Analiza e tregut është bazuar në rezultatet financiare të publikuara të bankave komerciale, që përgatiten në pajtim me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK).

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të karakterizohet si shumë stabil, me fare pak ndikim nga kriza e vazhdueshme në Eurozonë, e në veçanti në Evropën juglindore. Shumica e vendeve të rajonit pritet të kenë rritje më të ulët apo edhe të bien në recesion. Treguesit kryesorë të industrisë kanë vazhduar të paraqesin nivel të lartë likuiditeti dhe kapitalizmi, ndërsa cilësia e portfolios kreditore ka mbetur në një nivel që konsiderohet i kënaqshëm.

Zgjerimi i këtij sektori përmes kreditimit dëshmon një ngadalësim të lehtë, ndërsa zhvillimet negative në sektorin fiskal dhe atë të patundshmërive kanë pasur ndikim në zhvillimin normal të sektorit financiar.




Sektori financiar në Kosovë vazhdon të dominohet nga sektori bankar, i cili në vitin 2012, mbante 75 për qind të pasurive të përgjithshme. Shtimi i pasurive të përgjithshme të institucioneve financiare në tregun e Kosovës është ngadalësuar në vitin 2012, duke shënuar rritje për 7 për qind në krahasim me 8 për qind sa ishte në vitin 2011.

Pasuritë e përgjithshme të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishin 628.5 milionë euro. Kjo përbën një zvogëlim të lehtë në krahasim me vitin paraprak. Përqindja e tregut të pasurive të përgjithshme që Banka Raiffeisen në Kosovë mbante ishte 24 për qind.

Struktura e pasurive të Bankës Raiffeisen në Kosovë vazhdon të dominohet nga kreditë dhe paradhëniet për klientë. Në dhjetor të vitit 2012, 67 për qind të të gjitha pasurive ishin të përqendruara në kredi dhe paradhënie për klientë, pas provizionimit për humbjet nga kreditë. Kjo përcillet me kredi dhe paradhënie për banka, përfshirë ekspozimin ndaj Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), në vlerë prej 15 për qind. Llogaria me BQK-në përfshin edhe rezervat të cilat kërkohen nga rregulloret e BQK-së për rezervat minimale.



Bonot investive përbëjnë 10 për qind të pasurive tona. Bonot investive përfshijnë investimet në bono qeveritare të shteteve të BE-së dhe SHBA-ve, si dhe në bonot e thesarit të cilat për herë të parë u emetuan nga Qeveria e Kosovës.

Ngjashëm me rënien e trendit të rritjes së pasurive të gjithmbarshme, veprimtaria kreditore ka shënuar rritje me të ngadalshme në vitin 2012. Në vitin 2012, rritja e kredive konsumuese në tregun e Kosovës ishte 9 për qind, krahasuar me 16 për qind në vitin 2011.





Kreditë dhe paradhëniet e përgjithshme bruto të Bankës Raiffeisen në Kosovë deri më datë 31 dhjetor 2012 kapnin shumën prej 427.5 milionë euro (në vitin 2011: 429.1 milionë euro). Kjo rënie e vogël në krahasim me vitin 2011, e cila gjithashtu reflektohet në indikatorët tjerë të ekonomisë së Kosovës, rezulton nga kujdesi i shtuar gjatë dhënies së kredive nga Banka.

Proporcioni i tregut sa i përket kredive dhe paradhënies me 31 dhjetor 2012 ishte 25 për qind (në vitin 2011: 27 për qind). Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu ka bërë edhe zbritjet për humbje kreditore, në bazë të politikave për riskun kreditor. Këto zbritje për humbje kreditore arrijnë shumën prej 26 milionë euro (në vitin 2011: 27 milionë). Këto zbritje janë bërë për portfoliot kreditore të vlerësuar specifikisht dhe reflektojnë vlerësimin e riskut për portfolion kreditore nga Banka Raiffeisen në Kosovë.




Depozitat e klientëve vazhdojnë të mbesin burimi kryesor i financimit të bankave komerciale të Kosovës. Trendi i rritjes së depozitave të klientëve u ngadalësua gjatë vitit 2012 si rrjedhojë e rënies së depozitave të ndërmarrjeve publike dhe rënies së depozitave të individëve. Depozitat e klientëve në vitin 2012 ishin 513.9 milionë euro (në vitin 2011: 557.3 milionë euro). Proporcioni që Banka Raiffeisen në Kosovë mban në tregun e depozitave është 23 për qind e tërë sektorit bankar të Kosovës. Struktura e detyrimeve të bankës dominohet nga depozitat e klientëve, ngjashëm me rrjedhat në tregun e Kosovës në përgjithësi.



Baza e depozitave përbëhet kryesisht nga depozituesit vendorë, ndërsa financimi nga jashtë vendit, përfshirë bankat zhvillimore shumëkombëshe, mbetet i ulët. Gjenerimi vendor i mjeteve financiare gjithashtu kontribuon në stabilitetin më të madh të sektorit bankar dhe zvogëlon ndikimin e lëkundjeve në tregjet ndërkombëtare.

Norma mesatare e interesit të paguar për depozita të klientëve në Kosovë ishte 3.6 për qind, përdërisa në vitin 2011 ishte 3.5 për qind. (Burimi: Raporti i stabilitetit i BQK).






Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe i tejkalon kërkesat e përcaktuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Norma e adekuacisë së kapitalit për bankat komerciale të Kosovës vazhdon të mbetet 17 për qind, vlerë kjo që tejkalon dukshëm minimumin e domosdoshëm prej 12 për qind. 60 për qind të përbërjes së kapitalit të përgjithshëm është kapital i paguar (Burimi: Raporti i stabilitetit i BQK).

Struktura e kapitalit e Bankës Raiffeisen në Kosovë gjithashtu dëshmon proporcion të lartë të kapitalit aksionar (58 milionë euro), i cili më 31 dhjetor 2012 qëndronte në vlerë prej 58 për qind (në vitin 2011: 59 për qind). Fitimet e nxjerra ishin 41.2 milionë euro, përfshirë dividendën e shpërndarë në vitin 2012, në lartësi prej 12 milionë eurosh.



Banka Raiffeisen në Kosovë ka mbajtur normën e adekuacisë së kapitalit e cila siguron pajtueshmëri me Rregulloren e Bankës Qendrore mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit Bankar. Sipas Rregullores së Bankës Qendrore për Mjaftueshmërinë e Kapitalit Bankar, bankat komerciale që funksionojnë në Kosovë duhet të ruajnë normën prej 8 për qind të Kapitalit të Klasit 1, dhe 12 për qind të fondeve të gjithmbarshme të saj për të mbuluar riskun kreditor dhe riskun tjetër. Më 31 dhjetor 2012, Banka Raiffeisen në Kosovë kishte normë të adekuacisë së Kapitalit të Klasit 1 prej 12.7 për qind dhe normë të fondeve të gjithmbarshme vetanake prej 13.7 për qind.

Të ardhurat neto pas taksave në vitin 2012 ishin 12.6 milionë euro, që përbën një ngritje të lehtë në krahasim me vitin 2011 (në vitin 2011: 12.4 milionë euro). Të ardhurat e Raiffeisen Bank fuqishëm dominohen nga të hyrat e gjeneruara nga kreditë dhe paradhëniet, kryesisht nga kreditë dhe avanset për klientët lokalë. Kjo do të thotë se të ardhurat kryesisht gjenerohen në territorin e Kosovës dhe nuk preken nga krizat aktuale në disa vende të BE-së. Struktura e të ardhurave për vitin 2012 është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.



Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (përfshirë zhvlerësimin e pasurive fikse) më 31 dhjetor 2012 arrinin 22.8 milionë euro (në vitin 2011: 22.9 milionë). Proporcioni kosto-të ardhura është 58 për qind (në vitin 2011: 57 për qind). Shpenzimet për punonjës ngërthejnë edhe shpenzimet që ndërlidhen me ta, përfshirë trajnimin dhe zhvillimin profesional të tyre. Këto shpenzime vazhdojnë të përbëjnë pjesë të rëndësishme të shpenzimeve operative, pasi që Banka konsideron se punonjësit e saj përbëjnë asetin më të rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të saj.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Raiffeisen Bank Kosovë më 31 dhjetor 2012 ishte 675 (në vitin 2011: 708 punonjës).



Numri i degëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë më 31 dhjetor 2012 ishte 50, ndërsa numri i bankomateve dhe terminaleve të pikave të shitjes ka vazhduar të shtohet në tërë tregun e Kosovës, duke i bërë produktet bankare më të qasshme për qytetarët e Kosovës. Kjo strategji mundësoi lehtësimin e sjelljes së shërbimeve dhe produkteve të bankës tek klientët e saj. Rrjeti i degëve të bankës përbëhet nga 9 degë kryesore, 39 nëndegë, një zyrë për shërbime bankare për klientët 'premium' dhe një zyrë për korporata

Thesari

Tregu i parave dhe kostoja e parave në Kosovë

Viti 2012 ishte i suksesshëm sa i përket inkasimit dhe konsolidimit të depozitave. Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur të mbajë pjesën më të madhe të klientëve depozitues të vet. Falë besimit të shtuar në sistemin financiar, e në veçanti në brendin e Bankës Raiffeisen në Kosovë, likuiditeti i Bankës mbetet në nivel stabil, duke i ulur dukshëm kostot e likuiditetit të vet nga viti në vit. Menaxhimi më i kujdesshëm i pasurive dhe obligimeve ia ka bërë Bankës të mundshme mbajtjen e një niveli të ulët të kostos së parave në treg, në krahasim me konkurrencën e saj, gjë që në anën tjetër i ka dhënë mundësi për huadhënie me norma më të ulëta amatore për disa produkte të caktuara. Megjithatë, kostoja e likuiditetit në Kosovë mbetet ende e lartë për shkak të lakores së normës së interesit për euro. Kostoja e likuiditetit është e lartë kryesisht për shkak të parametrave të riskut për shtetin e Kosovës. Deri tani, Kosovës nuk i është bërë rangim ndërkombëtar nga agjencitë ranguese. Kjo bën që detyra e përcaktimit të çmimit të jetë e vështirë dhe si rrjedhojë vështirëson investimet e drejtpërdrejta të huaja në Kosovë.

Bonot qeveritare

Portfolio i letrave me vlerë të Bankës në bono qeveritare është rritur në 64 milionë euro, dhe zë rreth 10 për qind të bilancit të gjendjes. Në vitin 2012, Qeveria e Kosovës për herë të parë lëshoi bono afatshkurtra thesari. Duke qenë se Banka është një nga akterët primarë në Kosovë, ajo mori pjesë në shumicën e licitacioneve të organizuara me sukses.

Derivatet financiare

Portfolio e normës së interesit të Bankës për kundërkëmbime u rrit në 42 milionë euro. Rrjedhat në treg patën ndikim negativ në performansën e kësaj portfolio në vitin 2012. Kundërkëmbimet e normave të interesit shfrytëzohen për të evituar riskun nga probabiliteti i rritjes së koston së parasë. Në muajt dhe vitet në vijim ne besojmë se normat e tregut do të lëvizin nga normat aktuale të cilat janë më të ulëta historikisht.

Menaxhimi i likuiditetit dhe riskut

Banka Raiffeisen në Kosovë menaxhon likuiditetin e përgjithshëm të vet dhe riskun e interesit përmes Komitetit të Pasurive dhe Detyrimeve, në të cilin përfshihet edhe Departamenti i Thesarit. Proporcioni i pasurive totale likuide kundrejt pasurive totale, arrin në 31 për qind në të gjitha valutat. Banka Raiffeisen në Kosovë aplikon standardin e Raiffeisen Group, si dhe kornizat e Basel II dhe Basel III në vlerësimin e riskut. Kriteret Time to Wall dhe Going Concern për vlerësimin e riskut zbatohen së paku çdo gjysmë viti, ndërsa raportet për Menaxhmentin e Thesarit bëhen përditë.

Afarizmi nga këmbimi valutor

Afarizmi nga këmbimi valutor ka sjellë të ardhura prej mbi 1.67 milionë euro në vitin 2012. Këto të ardhura janë paksa më të ulëta se sa në vitin 2011. Zyra përkatëse e Bankës Raiffeisen në Kosovë është zyra më fitimprurëse e llojit në industrinë bankare të Kosovës. Përveç kësaj, afarizmi nga këmbimi valutor i ka mundësuar Bankës Raiffeisen në Kosovë qarkullim të fondeve në formë të afarizmit nga transferi i komisioneve.

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Të ardhurat nga këmbimi valutor	1,052	1,073	1,392	1,326	1,766	1,543

Valuta zyrtare e Kosovës është euro dhe kjo imponon kufizime në afarizmin nga këmbimet valutore.

Afarizmi nga ndërmjetësimi

Në vitin 2012, Banka Raiffeisen në Kosovë ka lansuar afarizmin e vet të ndërmjetësimi me bursa. Klientët e Bankës kanë mundësi që të kryejnë transaksionet në shumicën e bursave të botës. Ky tipar u mundëson klientëve blerjen e aksioneve dhe fondeve dhe mbajtjen e portfoliove në to.

Korporatat

Afarizmi bankar me korporata

Banka Raiffeisen në Kosovë sh.a. u shërben klientëve të vet në segmentin e korporatave përmes menaxherëve përkatës në zyrat qendrore. Në vitin 2012, Banka arriti ta përforcojë edhe më tej pozitën e vet në segmentin e korporatave të mëdha. Banka Raiffeisen në Kosovë mbetet kreditori më i madh i korporatave, duke mbajtur mbi 50 për qind të tregut. Si bankë universale që është, ajo ka vazhduar që kompanive të mëdha tu ofrojë një gamë të gjerë të produkteve bankare, përfshirë kreditë, menaxhimin e parasë së gatshme, afarizmin dokumentar, depozitat dhe këmbimet valutore.

Gjatë vitit 2012, Banka u ka shërbyer mbi 500 klientëve të ndryshëm, përfshirë kompani të mëdha dhe institucione financiare vendore, si dhe institucione financiare jobankare dhe korporata shumëkombëshe. Sa u përket pasurive, fokusi kryesor i Bankës mbeti ruajtja e cilësisë së portfolios së kredive dhe kushtimi i kujdesit të shtuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procedimit të kredive. Kjo veprimtari rezultoi me përshpejtimin e procedimit të kërkesave për kredi dhe siguroi reagim më të shpejtë ndaj ndryshimeve të gjendjes ekonomike të klientëve të ndryshëm.

Përkundër gjendjes jostabile ekonomike në rajon dhe krizës së vazhdueshme në Eurozonë, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të ruajë e madje edhe ta rrisë portfolion e kredive në nivel korporatash. Në këtë aspekt, ekspozimi kreditor në industri të caktuara (p.sh. klientë jociklorë) është shtuar dukshëm, ndërsa rritja kreditorë në industri të kufizuara, siç është financimi i projekteve, ka shënuar rritje më të ulët. Edhe pse faktorët e riskut janë rivlerësuar dhe ka pasur më shumë kujdes gjatë lëshimit të kredive të reja, vëllimi i pasurive arrin vlerën prej 158 milionë euro, që përbën një rritje prej 11 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Të ardhurat neto nga interesi u shtuan në 9 milionë euro, që përbën rritje prej 12 për qind në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa të ardhurat neto nga komisioni arrijnë 2.2 milionë euro, apo 12 për qind më shumë se vitin e kaluar. Gjatë kësaj periudhe vlera e RoRAC (Fitimi nga Kapitali me Risk të Përshtatur) arrin 138 për qind, që nënkupton rritje prej më shumë se 50 për qind në krahasim me vitin paraprak.

Mesatarja e cilësisë së portfolios kreditorë në librat e kredive për korporata është përmirësuar dukshëm gjatë periudhës raportuese, duke qenë se vëllimi i kredive të këqija ka rënë nga 11 për qind vitin e kaluar, në 7 për qind këtë vit. Kjo është rrjedhojë e shtimit të vigjilencës ndaj kredive problematike, duke i identifikuar problemet me kohë dhe duke kërkuar zgjidhjet për to në bashkëpunim të ngushtë me klientët e Bankës.

Gjatë vitit 2012 janë optimizuar procedurat kreditorë të Bankës Raiffeisen në Kosovë, me qëllim që kërkesat e klientëve të mund të përmbushen më shpejtë dhe në mënyrë më efektive. Efekti fillestar i këtij procesi ka qenë pozitiv. Në fushën e depozitave, banka ka konfirmuar reputacionin e mirë dhe besimin e klientëve që e gëzon.

Produktet për korporata

Departamenti i Produkteve për Korporata është themeluar në vitin 2012 si pjesë e Divizionit të Korporatave, me qëllim të krijimit të një lidhjeje më të fuqishme mes afarizmit primar investues dhe produkteve dhe shërbimeve financiare. Departamenti i Produkteve për Korporata zhvillon dhe menaxhon produkte dhe shërbime optimale financiare me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve gjithëpërfshirëse për kompanitë shumëkombëshe, korporatat e mëdha, institucionet financiare dhe ndërmarrjet e vogla.

Banka Raiffeisen në Kosovë synon të identifikojë mundësitë për investime për korporata dhe ndërmarrje të vogla, duke qenë se ka një pasqyrë të pastër të tërë spektrit investiv dhe zinxhirit furnizues, si dhe të sajojë produkte dhe mjete të cilat më së miri përshiaten me mundësitë e klientëve për zhvillim. Përmes Departamentit të Produkteve për Korporata, Banka ofron shërbime këshillëdhënëse dhe financiare lidhur me menaxhimin e parave të gatshme, menaxhimin e shitjes, financimin e projekteve, faktoringun dhe financimin tregtar. Ky departament përbëhet nga një ekip i ri specialistësh të produkteve, me përvojë të gjatë në financime speciale, siç janë financimi i projekteve, financimi në tregun e patundshmërive, financimi tregtar, me përvojë të gjatë në instrumentet ndërkombëtare financiare; si dhe në faktoring, duke u bërë kështu banka e parë që ofron produkte për financimin e të arkëtueshmeve në treg.

Gjatë vitit 2012, Banka Raiffeisen në Kosovë ka zhvilluar produkte që fokusohen në sigurimin e pasurive të klientëve dhe transaksioneve ditore afariste të tyre, në një treg dhe një mjedis të përgjithshëm afarist të ndryshueshëm. Ajo ka zhvilluar dhe ka zgjeruar një sërë produktesh dhe ka lansuar dy produkte të reja: faktoringun për korporata dhe linjën kreditorë për kapital punues (WCCL) për ndërmarrje të vogla. Përderisa faktoringu përbën një model alternativ të financimit, WCCL është produkt i financimit strukturor që i ofrohet ndërmarrjeve të vogla. Këto produkte ofrojnë fleksibilitet të theksuar në shfrytëzimin e fondeve, e përfundimisht rezultojnë me kosto më të ulët të financimit. Produktet e Bankës për

Financim të Tregtisë bëjnë që Banka Raiffeisen në Kosovë të jetë udhëheqës i tregut sa i përket gamës së produkteve në dispozicion.

Marrë parasysh fokusin në ofrimin e shërbimeve që ngërthejnë vlerë të shtuar, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të investojë në teknologji, duke i ngritur në nivel më të lartë zgjidhjet e veta për afarizëm bankar elektronik (e-banking), duke u ofruar klientëve mundësinë që të paguajnë tatimet, kontributet pensionale dhe obligimet doganore kudo qofshin dhe në çdo kohë të ditës. Përveç kësaj, Banka ka vazhduar fuqizimin e marrëdhënieve të veta me klientët strategjikë të vet, duke u ofruar atyre shërbime cilësore të cilat i dizajnon enkas për t'u përputhur me nevojat e tyre.

Menaxhimi i Shitjeve, përmes veglës për Menaxhimin e Marrëdhënieve me Klientët (oCRM), ka vazhduar të sigurojë procese efikase të shitjes, ndërsa informatat e strukturuar dhe azhure mbi klientët mundësojnë planifikim më të mirë të llogarive dhe përmbushje të nevojave të klientëve në kohë. Përveç kësaj, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe diferencimitin e burimeve të të ardhurave, duke u bazuar në nevojat e tregut financiar dhe të klientëve, me qëllim të sigurimit të sinergjive mes shërbimeve për klientë dhe shërbimit të produkteve financiare. Pozita e Bankës si udhëheqëse në treg, madhësia e saj dhe njohuritë që i zotëron, bëjnë që Banka Raiffeisen në Kosovë të gëzojë përparësi unike që t'i përmbushë nevojat komplekse financiare të klientëve, duke u shndërruar kështu në bankën e preferuar për klientët e vet.

Ndërmarrjet e vogla

Ndërmarrjet e vogla janë tejet të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, andaj Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të ofrojë shërbime dhe përkrahje financiare për ata klientë të cilët ende vazhdojnë të kenë nevojë për zgjerim të afarizmit. Sa u përket kërkesave financiare të Ndërmarrjeve të Vogla, Banka ka përkrahur më tej të gjitha ndërmarrjet e vogla që i ka në listën e klientëve, me kushte konkurruese. Përveç kësaj, ne kemi vazhduar të ofrojmë shërbime dhe financim për ndërmarrjet e vogla të cilat rishitas na janë bashkuar. Falë përparimit të ndërmarrjeve të vogla si rrjedhojë e përkrahjes financiare të ofruar, gjatë vitit 2012 dhjetë klientë nga segmenti i ndërmarrjeve të vogla, me ekspozim të gjithmbarshëm prej 3 milionë euro, janë transferuar në segmentin e bizneseve të mëdha tek Korporatat.

Për të shtuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve për klientët e segmentit të Ndërmarrjeve të Vogla, Banka Raiffeisen në Kosovë e ka ristrukturuar segmentin afarist të Ndërmarrjeve të Vogla. Tani, ai është i ndarë në tri zona rajonale; me tre menaxherë regjionalë të llogarive dhe 13 menaxherë të marrëdhënieve me klientë të Bankës Raiffeisen në Kosovë, me përvojë dhe të suksesshëm, tani u ofrojnë shërbime klientëve të Bankës në nivel rajonal. Falë trajnimeve të vazhdueshme dhe investimit në Menaxherët e Marrëdhënieve me Ndërmarrjet të Vogla të Bankës, ata tani janë të specializuar në fushën e analizave financiare dhe këshillimit të klientëve.

Gjatë vitit 2012, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vënë në funksion modulën e përcaktimit të çmimeve në bazë të riskut. Ky modul i ri mundëson përcaktimin e çmimeve përkatëse për nivelin e riskut që klienti ka. Për më tepër, Banka ka vazhduar që t'i inkurajojë bizneset e vogla që të shtojnë nivelin e transparencës dhe të shtojnë përdorimin e shërbimeve bankare elektronike (e-banking). Prioritet i është dhënë fuqizimit të marrëdhënieve me klientët ekzistues dhe zhvillimit të një marrëdhënieje afatgjatë me klientët e rinj.

Sa u përket kushteve të financimit për ndërmarrjet e vogla, Banka vazhdimisht ia adapton ofertën e vet nevojave të tregut. Gjatë vitit 2012, si rezultat i marrëdhënieve të shkëlqyeshme mes klientëve dhe Bankës, Banka vëri në funksion një produkt atraktiv: një linjë të kapitalit punues me kriterë tejet konkurruese. Përveç kësaj, për t'i përkrahur agrobizneset në Kosovë, Banka Raiffeisen në Kosovë dhe USAID kanë arritur marrëveshje për financimin e këtij sektori tejet të rëndësishëm të ekonomisë, i cili do të tu mundësojë ndërmarrjeve të vogla në industrinë bujqësore që të përmirësojnë më tej strukturat e tyre dhe kështu ta zhvillojnë tërë sektorin.

Falë përkushtimit të vazhdueshëm të dëshmuar ndaj klientëve të segmentit të Ndërmarrjeve të Vogla, Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të mbetet një nga bankat udhëheqëse në treg sa i përket segmentit të ndërmarrjeve të vogla, me rreth 35 për qind të tregut.

Biznesi retail

Mikrobizneset

Në vitin 2012, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar zhvillimin e Segmentit të Mikrobizneseve, si një nga shtyllat kryesore të Bankës. Ajo e ka arritur cakun e vet – ofrimin e shërbimeve për 15.000 mikrobiznese, duke siguruar shërbime të cilësisë së lartë në fokus të cilave ishte klienti. Gama e produkteve të ofruara u pasurua edhe më tej, me qëllim të shtimit të efikasitetit dhe efektivitetit të afarizmit të klientëve.

Bizneseve u janë ofruar linja të reja kreditore, duke ndikuar kështu pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj portfolioje ngërthen huadhënien dhe përkrahjen e mëtejme për sektorin e bujqësisë. Në bashkërendim të ngushtë me autoritetet përkatëse lokale dhe kombëtare, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar përkrahjen e sektorit bujqësor në Kosovë, në veçanti përmes financimit të drejtpërdrejtë të evenimenteve që promovojnë produktet dhe kultivimet në vend. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe me përkrahje të USAID, janë ofruar kushte dhe mundësi për të rritur më tej kreditimin me kushte të favorshme për biznese bujqësore dhe partnerë lokalë. Njëkohësisht, në partneritet me USAID-in, Banka është angazhuar në përkrahjen e bizneseve të reja të cilat ende ishin në faza të hershme të tregtimit apo zhvillimit.

Banka Raiffeisen në Kosovë do të vazhdojë të përkrahë rritjen ekonomike të Kosovës, duke i përkrahur mikrobizneset, të cilat përbëjnë shumicën e kompanive të regjistruara në vend. Qasjet e reja dhe diversiteti i produkteve të ofruara do të përbëjnë gurthemelin e marrëdhënies së bankës me klientë ekzistues dhe potencialë të këtij segmenti.

Klientët individualë

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar ofrimin e një game të gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare, qofshin standarde apo të sajura enkas për nevoja të individëve, me të cilat mëton të përmbushë nevojat e klientëve individualë. Në vitin 2012, Banka ka ofruar shërbime për më shumë se 255.000 klientë individualë aktivë, përmes 50 degëve të veta anembanë vendit.

Gjatë vitit 2012, Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur të disbursojë shumën shtesë prej 60 milionë eurosh, si dhe njëkohësisht ka arritur të zvogëlojë numrin e kredive të këqija në këtë sektor. Sa u përket depozitave, Banka ka vazhduar të mbetet brendi më i preferuar për shumë depozitues të rinj.

Për të zhvilluar më tej aftësitë e punonjësve të shitjes, Banka ka zhvilluar disa kurse trajnimi sa u përket shitjes, shërbimeve dhe produkteve, dhe ka ofruar një skemë stimuluese dhe shpërblyese. Për më tepër, gjatë vitit 2012, synimi i Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte shtimi i efikasitetit përmes thjeshtësimit të proceseve të brendshme, të cilat më pas rezultojnë me shkurtime të kohës së pritjes dhe shërbime më cilësore për klientë.

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të sigurojë se klientët e saj Premium do të kenë mundësi që të diskutojnë planet dhe mundësitë investuese të tyre në mënyrë të thuktë me menaxherët e caktuar enkas për punë me ta, dhe në hapësira ekskluzive të punës të cilat janë të parapara vetëm për klientët e kësaj kategorie. Në fund të vitit 2012, Banka u ka ofruar shërbime bankare më shumë se 7.000 klientëve Premium në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës.

Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve

Mjedisi afarist ndryshon çdo ditë e edhe marrëdhënia me klientët gjatë vitit 2012 ka ndryshuar poashtu, me ç'rast ne kemi vazhduar kalimin nga marrëdhënia statike në marrëdhënie më dinamike. Gjatë kësaj periudhe, Banka Raiffeisen në Kosovë ka ridizajnuar Paket e Llogarive Rrjedhëse, duke ofruar më shumë produkte dhe shërbime dhe duke i bërë ato më joshëse për klientët. Për më tepër, Banka i ka fuqizuar më tej kanalet e veta elektronike duke mundësuar kryerjen e pagesave të ndryshme përmes shërbimeve bankare elektronike.

Gjatë vitit 2012, Banka ka qenë e fokusuar në ofrimin e produkteve kreditore të lehta, të përshtatshme dhe efikase në aspektin kohor, gjë që u ka mundësuar klientëve qasje të shpejtë në lloje të ndryshme të kredive, siç janë hipotekat, kreditë për shtëpi apo kreditë personale. Të gjitha këto kredi sigurohen përmes Sigurimit të kthimit të kredisë (PPI), që është një produkt unik në treg.

Kanalet e distribuimit

Banka Raiffeisen në Kosovë ka një rrjet të gjerë të degëve, i cili plotësohet më tej me kanale alternative dhe të avancuara të cilat u mundësojnë klientëve të degëve që të gëzojnë qasje të lehtë në produkte bankare. Qasje dhe prezenca e Bankës janë unike në treg. Cilësia e rrjetit të degëve përcaktohet nga niveli i afërsisë me klientin, frekuenca dhe qasshmëria; rrjedhimisht, Banka Raiffeisen në Kosovë është me qëllim e pranishme anekënd Kosovës dhe u ofron klientëve të vet një spektër të gjerë produktesh dhe shërbimesh së cilësisë superiore.

Banka ka filluar të kryejë disa ndryshime në strukturën e rrjetit të degëve të veta, duke i ofruar stafit të vet që punon me klientë mundësi të specializimit në ekzekutimin e shumë detyrave përnjëherë, me qëllim të ofrimit të disa shërbimeve për klientë gjatë një ndërveprimi të vetëm. Punonjësit e shitjes posedojnë aftësitë dhe shkathtësitë përkatëse për t'i trajtuar të gjitha kërkesat e klientëve dhe për t'i këshilluar ata lidhur me nevojat financiare të tyre.

Viti 2012 ishte vit i konsolidimit dhe përmirësimit të hapësirave të degëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë. Banka e ka modernizuar rrjetin e degëve të veta, duke i rimodeluar dy degët e saj kryesore në Ferizaj dhe Mitrovicë dhe duke e zhvendosur nëndegën e vet në Prizren. Këto veprime e konfirmojnë përkushtimin e Bankës për të krijuar mjedise komflore dhe të përshtatshme të punës për klientët e vet.

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të ofrojë shërbime bankare për klientët e vet edhe përmes Qendrës së thirrjeve. Fokus kryesor gjatë këtij viti ishin sigurimi i shërbimeve superiore, përkrahja e veprimtarisë afariste dhe sigurimi i besimit nga klientët, duke zhvilluar kështu marrëdhënie afatgjatë me klientët. Punonjësit që ofrojnë shërbimet bankare përmes Qendrës së thirrjeve janë të përgatitur mirë dhe profesionalë dhe kanë njohuri të gjera mbi të gjitha produktet bankare.

Rrjeti i bankomateve dhe terminaleve të pikave të shitjes vazhdon të jetë një nga rrjetet më të mëdha të sektorit bankar. Në fund të dhjetorit 2012, numri i pikave aktive të shitjes nëpër biznese ishte 1.647, ndërsa Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të ndjek trendin e zgjerimit të rrjetit të tyre. Për të siguruar shërbime të besueshme dhe efikase, Banka ka një ekip të përkushtuar që siguron se kërkesat e klientëve adresohen në mënyrë adekuatë.

Shërbimi për klientë

Fokusi i Bankës Raiffeisen në Kosovë në kuptim të arritjes së standardeve më të larta të shërbimeve për klientë, ofrimit të shërbimeve të shkëlqyeshme dhe përmbushjes së kërkesave të klientëve kanë vazhduar të jenë një nga prioritetet tona strategjike gjatë vitit 2012. Me qëllim të njohjes së kërkesave të klientëve të bankës si dhe përvojave të tyre me shërbimet tona, dëgjimi i zërit të klientit dhe marrja e mendimeve të tyre përbënte një nga prioritetet tona përgjatë tërë vitit.

Rëndësia e trajtimit të mirëfilltë të ankesave, shpejtësia e zgjidhjes së tyre dhe ndikimi i kësaj në nivelin e kënaqësisë së klientëve është adresuar përmes sistemeve implementuese të cilat do të përkrahin përkushtimin e palëkundur të Bankës për të ngritur cilësinë e shërbimeve. Një nismë për zgjerimin e programit të ofrimit të shërbimeve të shkëlqyera ka filluar në tremujorin e fundit të vitit, duke implementuar një mekanizëm për matje të cilësisë, me të cilin do të monitorohen dhe përmirësohen shërbimet e ofruara përmes Qendrës së Thirrjeve dhe shërbimit për klientë Premium të Bankës.

Menaxhimi i kredive dhe riskut

Edhe viti 2012 ka qenë vit i aktiviteteve të shumta në sferën e menaxhimit të riskut, që është kyçe për veprimtarinë e Bankës Raiffeisen në Kosovë, ngase i prek të gjitha veprimtaritë që ndikojnë në profilin e riskut të Bankës. Korniza e menaxhimit të riskut bankar, funksioneve dhe aktiviteteve gjegjëse janë menaxhuar në pajtim me praktikatat më të mira dhe udhëzimet e Raiffeisen Bank International. Identifikimi, matja, monitorimi dhe kontrollimi i riskut ishin dizajnuar për të siguruar se vendimet që ndërthejnë doza risku të jenë në pajtueshmëri me strategjinë dhe objektivat e Bankës.

Menaxhimi i riskut të portfoliove ishte aktiviteti kryesor i këtij viti, duke u përqendruar edhe më tej në implementimin e mjeteve të inkasimit dhe funksionalizmin e mëtejshëm të sistemit për paralajmërim të hershëm. Kjo ka rezultuar me procedura dhe funksione të reja të cilat ndihmojnë në identifikimin e përkeqësimit të portfolios dhe rishikimin e indikatorëve kryesorë të performansës. Përveç kësaj, janë ndërmarrë edhe shumë aktivitete përcjellëse që kishin për qëllim përmirësimin e normës së inkasimit të huave të këqija.

Menaxhimi efektiv i riskut, kundrejt masave të riskut për të cilat është arritur pajtimi që të ndërmerren, mbetet i një rëndësie fundamentale për Bankën. Për këtë arsye, përmirësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme për ofrimin e shërbimeve më të mira për klientët ngërthente një sërë aktiviteteve, siç janë implementimi i produkteve të reja të Linjës Kreditore të Kapitalit Punues dhe Faktoringut, përmirësimin e proceseve të kreditimit që rezultoi me përshejtim të procedimit të kredive, adaptim të mëtejshëm të listave vlerësuese si vegël për vendimarrje, dhe implementimin e Sistemit të Procedimit të Kërkesave (APS) për segmentin e Korporatave.


Basel II dhe Basel III

Banka Raiffeisen në Kosovë konfirmon se të gjitha kërkesat për implementimin e Basel II janë plotësuar brenda afatit kohor të përcaktuar nga Zyra Kryesore në Vjenë. Të gjitha metodat, mjetet, proceset dhe procedurat që janë implementuar përbëjnë praktikatat më të avancuara të menaxhimit të riskut. Marrë parasysh zhvillimet e reja në tregjet financiare dhe kërkesat e reja për zhvillim të mëtejshëm, Departamenti për Menaxhimin e Riskut i Bankës ka filluar implementimin e kërkesave të reja të Basel III, me fokus të veçantë në fushën e riskut të likuiditetit.

Operacionet

Pagesat

Gjatë vitit 2012 kujdes i veçantë i është kushtuar procedimit të pagesave. Numri i pagesave hyrëse në vitin 2012 është rritur me 15 për qind në krahasim me vitin 2011, ndërsa numri i pagesave dalëse është shtuar për 6 për qind në krahasim me vitin paraprak. Vlera e gjithmbarshme e pagesave ishte € 4,374 milionë.





Shfrytëzimi i shërbimeve bankare elektronike (e-banking) ka ndikuar në shtimin e numrit të transaksioneve dhe përdoruesve. Gjatë vitit 2012, numri i përdoruesve të shërbimeve elektronike bankare (e-banking) është rritur për 11 për qind në krahasim me vitin 2011. Numri i përgjithshëm i transaksioneve përmes shërbimeve elektronike bankare (e-banking) është rritur për 30 për qind në krahasim me vitin 2011.

Financimi tregtar

Banka Raiffeisen në Kosovë përkrah dhe financon një vëllim të rëndësishëm të tregtisë vendore dhe ndërkombëtare, duke ofruar produkte të ndryshme financiare tregtare.

Siç paraqitet në diagramin e mposhtëm, gjatë vitit 2012 vëllimi i produkteve të financimit tregtar është rritur në 74.6 milionë euro.



Gjithashtu, vlera e mbetjeve të pakthyera nga afarizmi i financimit tregtar në fund të vitit 2012 kapte shifrën prej 35.9 milionë euro.

Procedimi i pagave

Procedimi i pagave është një nga produktet që Banka ua ofron klientëve të vet në segmentet e bizneseve; duke ua proceduar listat e pagave dhe duke i kryer barazimet gjegjëse.

Numri i gjithmbarshëm i listave të pagave të proceduara gjatë vitit 2012 shënoi rritje prej 20 për qind në krahasim me vitin 2011.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë shërbime që Banka ua ofron klientëve në segmentet e bizneseve të cilët kanë llogari në Bankën Raiffeisen në Kosovë. Numri i gjithmbarshëm i pagesave gjatë vitit 2012 shënon rritje prej 4 për qind në krahasim me vitin paraprak.

Teknologjia informative dhe e komunikimit

Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të investojë në teknologji informative dhe të komunikimit (TIK). Departamenti i TIK menaxhon dhe kujdeset për një numër të madh të aplikacioneve dhe sistemeve të sofistikuar dhe komplekse. Si rezultat i nivelit të lartë të profesionalizmit, në vitin 2012, Departamenti i TIK ka validuar me sukses certifikatën ISO/IEC 20000-1:2005, të fituar një vit më parë, kur Banka Raiffeisen në Kosovë u bë banka e parë në Evropën juglindore që mori këtë vlerësim ndërkombëtar.

Ajo që e bën Bankën Raiffeisen në Kosovë unike në tregun e Kosovës por edhe në rajon është matura në Menaxhimin e Kontinuitetit të Biznesit (BCM) dhe Qendra efikase për Rimëkëmbje nga Katastrofat (DRC). Gjatë vitit 2012 janë testuar edhe BCM edhe DRC, gjatë të cilit operacionet e rregullta janë kryer duke i kaluar shërbimet e TI në DRC, ndërsa kjo nuk ka pasur kurrfarë ndikimi tek klientët apo shërbimet e ofruara nga Raiffeisen Bank. Ky simulim dëshmon se Banka Raiffeisen në Kosovë do të mund të tejkalonte situatën kur Qendra Primare e të Dhënave (Dhoma e Serverit) do të shkatërrohej në tërësi dhe se kjo nuk do të kishte kurrfarë ndikimi negativ tek klientët, gjë që bën që Banka Raiffeisen në Kosovë të jetë bankë e klasit botëror sa i përket teknologjisë informative dhe shërbimeve gjegjëse. Departamenti i TIK është i përkushtuar që të vazhdojë me sukseset e veta dhe t'i mundësojë Bankës kërkimin e mundësive të reja afariste, duke ofruar zgjidhje dhe shërbime të qëndrueshme të sigurta dhe efektive për klientët e vet.

Trajnimi dhe menaxhimi i punonjësve

Viti 2012 ishte vit stabil sa u përket rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve të rinj, kështu që pikë kryesore e përqendrimit ishte zhvillimi i kapaciteteve njerëzore brenda organizatës. Numri i gjithmbarshëm i punonjësve që janë avancuar në pozitë përmes proceseve të përzgjedhjes së brendshme ishte 67, gjë që shënon rritje prej 35% në krahasim me vitin 2011. Gjatë vitit 2012, Bankës iu bashkëngjiten 36 punonjës të rinj përmes procedurave të hapura të rekrutimit dhe punësimit.

Banka Raiffeisen në Kosovë e ka rikonfirmuar misionin e vet për të qenë punëdhënësi i preferuar, duke ofruar mundësi për zhvillim të karrierës për punonjësit e vet dhe për punëkërkuesit potencialë. Përveç kësaj, avancimi i potencialeve të reja dhe fuqisë punëtore në përgjithësi ka mbetur një nga aktivitetet e rregullta të Departamentit për Burime Njerëzore dhe Trajnim. Në këtë aspekt, Banka ka përkrahur projektin 'Atomi' (të implementuar nga Encompass Center) synimi i së cilit ishte identifikimi dhe përkrahja e individëve me koeficient të lartë të inteligjencës.

Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit ka menaxhuar dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të ndërlidhura me avancimin e studentëve të dalluar në Kosovë. Banka e ka vazhduar programin e vet të punës praktike për studentët më të dalluar të disa universiteteve të Kosovës; gjatë vitit 2012, programin e punës praktike e kanë vijuar 67 studentë. Pranimi i 424 kërkesave nga studentët për këtë program dëshmon se Raiffeisen Bank mbetet një nga institucionet punëdhënëse të preferuara për studentët e universiteteve, të cilët shprehin dëshirën për të na u bashkëngjitur që në hapat e parë të karrierave të tyre.

Banka Raiffeisen në Kosovë është e përkushtuar që të sigurojë se punonjësit e vet do të zhvillojnë njohuritë dhe shkathësitë e tyre, duke u ofruar atyre një spektër të gjerë të mundësive për të mësuar dhe për tu avancuar, përmes trajnimeve në vend të punës, trajnimeve të brendshme dhe të jashtme, mësimin elektronik (e-Learning), detyrave mësimore dhe përfshirjes në projekte sfiduese lokale dhe ndërkombëtare. Këto projekte kanë rezultuar me shtim të njohurive në fushën e produkteve dhe shërbimeve bankare. Kështu, banka fiton përparësi konkurruese në treg, duke u ofruar klientëve të vet shërbime më profesionale dhe efikase.

Gjatë vitit 2012, 88 për qind të punonjësve kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnimi dhe pothuajse të gjithë kanë marrë pjesë në punëtori të llojllojshme. Shifrat dëshmojnë nivel të lartë të arritjes së standardeve evropiane përkatëse, duke qenë se gjatë vitit 2012 punonjësit kanë kaluar mesatarisht 3.4 ditë në trajnime. Duke e zgjeruar spektrin e trajnimeve të ofruara, shtuar numrin e trajnerëve të brendshëm dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e trajnimeve të ofruara, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve ka arritur të organizojë më shumë kurse për punonjësit e Bankës. Gjatë vitit 2012 janë aranzhuar 2,644 ditë trajnimi dhe janë mbajtur 292 seanca.

Banka Raiffeisen në Kosovë bashkëpunon me ofrues të ndryshëm të shërbimeve të trajnimit në Kosovë dhe jashtë saj në realizimin e disa programeve specifike të trajnimit. Analiza e vazhdueshme e nevojave për trajnime mundëson krijimin e programeve të posaçme të trajnimit, të dizajnuara enkas për të adresuar nevojat e punonjësve përkatës. Për disa punonjës ekzistojnë edhe plane individuale të avancimit.

Mësimi elektronik (e-Learning) u dëshmuar si metodë e preferuar gjatë vitit 2012. Në vitin e dytë të ekzistimit të tij, u shfaq një nivel mbresëlënës i interesimit dhe përkrahjes nga punonjësit e Bankës, të cilët kërkonin të marrin pjesë në kurset e krijuara nga Banka dhe nga Raiffeisen Bank International (RBI). Gjatë vitit 2012, mbi 4120 punonjës janë paraqitur për kurse të Bankës dhe mbi 130 janë regjistruar në kurse të RBI. Pritet që përmes mësimit elektronik dhe mësimit të përzier Banka të jetë më efikase dhe më efektive në jetësimin e programeve trajnuese për të gjithë punonjësit, edhe atë brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore.

Në vitin 2012 u lansua një nismë tjetër e brendshme zhvillimore, e quajtur Diamond Academy. Ky program mëton të avancojë njohuritë dhe ekspertizën e punonjësve të Bankës, përmes një kombinimi motivues të metodave praktike, alternative dhe akademike të mësimdhënies.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të sponsorojë studime postdiplomike dhe kurse të veçanta, si pjesë e përkrahjes specifike dhe avancimit të kapaciteteve të stafit. Si rezultat i kësaj përkrahjeje, janë sponsoruar studimet e 16 punonjësve, të cilat pritet të përfundojnë në vitin 2013. Për më tepër, një sërë kursesh ekzistuese dhe të reja profesionale u ofrohen punonjësve të Bankës, në fusha dhe tema të ndryshme. 'Mësimi është proces i përrjetshëm' - është një nga mesazhet kryesore që u përçohet të gjithë punonjësve të Bankës.

Pasqyrat financiare

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2012, të përgatitura në pajtim me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Shënim: Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në gjuhën angleze.
Prandaj, versioni në gjuhën angleze e mbizotëron versionin e përkthyer në gjuhën shqipe.

Deklarata mbi përgjegjësitë e menaxhmentit	28
Raporti i auditorit të pavarur	
Pasqyra individuale e pozitës financiare	30
Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse	31
Pasqyra individuale e ndryshimit të kapitalit	32
Pasqyra individuale e rrjedhjes së parasë	33
Shënimet për pasqyrat financiare individuale	34
1. Informata të përgjithshme	34
2. Baza e përgatitjes	34
3. Politikat kryesore të kontabilitetit	34
4. Menaxhimi i riskut financiar	43
5. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare	54
6. Para të gatshme, ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme	55
7. Hua nga bankat tjera	55
8. Kredi dhe paradhënie tek klientët	56
9. Kreditë tjera	57
10. Investimet në letra me vlerë	57
11. Investimet në entitete vartëse	57
12. Pasuri të tjera	57
13. Përmirësimet në objektet me qira, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme	58
14. Depozitat e klientëve	58
15. Depozita dhe huazime nga bankat	59
16. Detyrime tjera	59
17. Kapitali aksionar	60
18. Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet për to	60
19. Të ardhurat nga tarifatat dhe shpenzimet për to	60
20. Të ardhura tjera	61
21. Shpenzimet për punonjës	61
22. Shpenzime tjera operative	61
23. Tatimi në të ardhura	62
24. Garancitë dhe zotimet	63
25. Transaksionet me palët e ndërlidhura	64
26. Ngjarje në vijim	64

Deklarata mbi përgjegjësitë e menaxhmentit

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të RAIFFEISEN BANK KOSOVO sh.a.


Në më datën 31 dhjetor 2012 i kemi përgatitur pasqyrat financiare për vitin që e lamë pas, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Raiffeisen Bank Kosovo sh.a. (në tekstin e mëtejme 'Banka') më 31 dhjetor 2012 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin kaluar. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës, të cilat mund të ndryshohen për të pasqyruar me saktësi të arsyeshme pozitën financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përfshirë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur pasuritë e Bankës dhe për të zbuluar dhe parandaluar manipulimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuete kontabile, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur me gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të kujdesshme, dhe se gjatë kësaj janë përcjellë Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues.

Prishtinë, Kosovë
20 mars 2013

Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Robert Wright
Kryesues i Bordit Menaxhues



Shukri Mustafa
Anëtar i Bordit Menaxhues



Iliriana Toçi
Anëtare e Bordit Menaxhues



Johannes Riepl
Anëtar i Bordit Menaxhues



Deloitte Kosovo sh.p.k
St. Bedri Pejani, no.3
Prishtina 3, 10030
Kosovo

Tel: + 381 38 245 582/3
Fax: + 381 38 245 584
www.deloitte.com

Raporti i auditorit të pavarur

Për aksionarët dhe menaxhmentin e RAIFFEISEN BANK KOSOVO sh.a.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të RAIFFEISEN BANK KOSOVO sh.a. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicitës financiare më 31 dhjetor 2012 dhe pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të RAIFFEISEN BANK KOSOVO sh.a. më 31 dhjetor 2013 si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Prishtinë, Kosovë
20 mars 2013


Pasqyra individuale e pozitës financiare

(vlerat në € 000)	Shënimet	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Pasuritë			
Paraja e gatshme, ekuivalentët e saj dhe rezerva e obligueshme	6	86,218	90,365
Huatë për bankat tjera	7	46,103	85,910
Kreditë dhe paradhëniet për klientë	8	401,066	402,110
Kredi të tjera	9	20,873	30,920
Investimet në letra me vlerë	10	64,102	62,873
Investime në degët vartëse	11	333	333
Pasuri tjera	12	2,188	1,945
Përmirësime në objekte me qira, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme	13	7,613	8,318
Gjithsej pasuri		628,496	682,774
Detyrime			
Depozita të klientëve	14	513,869	557,277
Depozita dhe huazime nga bankat	15	4,213	12,684
Detyrime tjera	16	9,530	12,910
Detyrimet tatimore të shtyra		1,648	846
Gjithsej detyrime		529,260	583,717
Kapitali i aksionarëve			
Kapitali aksionar	17	58,000	58,000
Fitimi i mbajtur		41,236	40,615
Rezerva tjera		-	442
Gjithsej kapitali aksionar		99,236	99,057
Gjithsej detyrime dhe kapital aksionar		628,496	682,774

Miratuar për publikim nga ana e Menaxhmentit të Raiffeisen Bank Kosovo sh.a. dhe nënshkruar në emër të të njëjtit më 20 mars 2013.



Shukri Mustafa
Kryeshf i Operacioneve dhe TI
Anëtar i Bordit Menaxhues



Robert Wright
Drejtor Ekzekutiv
Kryesus i Bordit Menaxhues

Pasqyra individuale e pozitës financiare duhet të lexohet në ndërlidhje me shënimet përkatëse që përbëjnë pjesë të pasqyrave financiare individuale në faqet 34 deri 64.

Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse

(vlerat në € 000)	Shënimet	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Të ardhura nga interesi	18	47,606	50,144
Shpenzime për interesi	18	(10,266)	(11,834)
Neto të ardhura nga interesi		37,340	38,310
Shpenzimet për rezerva nga huatë	8	(5,523)	(6,545)
Kthimi për kredi të shlyera		1,016	735
Garancitë dhe zotimet		(221)	(23)
Neto të ardhura nga interesi pas provizioneve		32,612	32,477
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	19	10,881	10,967
Shpenzimet për tarifa dhe komisione	19	(3,084)	(3,149)
Shpenzimet për tarifa dhe komisione		135	17
Vlerësimi neto i instrumenteve financiare për tregtim		(570)	(533)
Vlerësimi neto i investimeve kapitale		500	84
Të ardhura tjera operative	20	82	223
Të ardhurat operative		40,556	40,086
Shpenzime për punonjës	21	(10,685)	(10,585)
Shpenzime tjera operative	22	(15,701)	(15,724)
Fitimi para tatimit në të ardhura		14,170	13,777
Shpenzimet për tatim në të ardhura	23	(1,549)	(1,386)
Fitimi për vitin		12,621	12,391
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse			
Rezultati i vlerësimit të instrumenteve financiare në dispozicion për shitje, të regjistruara në kapital		(442)	145
Gjithsej të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		12,179	12,536

Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet në ndërlidhje me shënimet përkatëse që përbëjnë pjesë të pasqyrave financiare individuale në faqet 34 deri 64.

Pasqyra individuale e ndryshimit të kapitalit

(vlerat në € 000)				
	Kapitali aksionar	Fitimet e arritura	Rezerva tjera	Gjithsej kapitali i aksionarëve
Bilanci më 1 janar 2011	58,000	33,224	297	91,521
Dividendë e shpërndarë	-	(5,000)	-	(5,000)
Fitimi për vitin	-	12,391	-	12,391
Vlerësimi i instrumenteve financiare AFS	-	-	145	145
Bilanci më 31 dhjetor 2011	58,000	40,615	442	99,057
Dividendë e shpërndarë	-	(12,000)	-	(12,000)
Fitimi për vitin	-	12,621	-	12,621
Vlerësimi i instrumenteve financiare AFS	-	-	(442)	(442)
Bilanci më 31 dhjetor 2012	58,000	41,236	-	99,236

Pasqyra individuale e ndryshimit të kapitalit duhet të lexohet në ndërlidhje me shënimet përkatëse që përbëjnë pjesë të pasqyrave financiare individuale në faqet 34 deri 64.

Pasqyra individuale e rrjedhjes së parasë

(vlerat në € 000)	Shënimet	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Rrjedha e parasë nga veprimtaria operative			
Interesi i përlogaritur nga kreditë		46,147	47,175
Interesi i përlogaritur nga blerjet		94	1,205
Interesi i përlogaritur nga bonot qeveritare		1,665	481
Interesi i paguar		(10,978)	(13,244)
Komisionet dhe tarifat e pranuar		10,895	10,787
Komisionet dhe tarifat e paguara		(3,084)	(3,149)
Neto valorizimi i investimeve kapitale		500	-
Të ardhura tjera të pranuar		1,106	977
Shpenzimet e paguara për punonjës		(10,452)	(10,309)
Shpenzime operative tjera të paguara		(11,511)	(12,735)
Tatimi i paguar në të ardhura		(1,295)	(1,620)
Rrjedha e parave nga veprimtaria operative para ndryshimit të pasurive operative dhe detyrimeve		23,087	19,568
Ndryshimet në pasuri operative dhe detyrime			
Neto (zvogëlimi) rritja e rezervës së domosdoshme për likuiditet		5,764	(4,687)
Neto zvogëlimi i huave nga bankat tjera		39,804	80,887
Neto rritja në kredi dhe paradhënie për klientë		5,978	(68,379)
Neto rritja në bono qeveritare		(1,950)	(22,002)
Neto (rritja) zvogëlimi në pasuri tjera		(5)	(75)
Neto rritja në llogari të klientëve		(43,465)	7,100
Neto rritja (zvogëlimi) në depozita nga bankat		(465)	249
Neto rritja (zvogëlimi) në detyrime tjera		(3,289)	717
Neto rrjedha e parasë nga veprimtaria operative		25,459	13,378
Rrjedha e parasë nga veprimtaria investive			
Pagesat për përmirësime të objekteve me qira, pajisje dhe pasuri të paprekshme		(2,981)	(2,839)
Neto para të gatshme të shfrytëzuara në veprimtari investive		(2,981)	(2,839)
Rrjedha e parasë nga veprimtaria financuese			
Shpagimi i huazimeve		(8,891)	(16,603)
Dividenda të shpërndara		(12,000)	(5,000)
Neto rrjedha e parasë nga veprimtaria financuese		(20,891)	(21,603)
Efëkti i normave të këmbimit valutor		30	46
Neto pakësimi i parave të gatshme dhe ekuivalenteve të parasë së gatshme		1,617	(11,018)
Para të gatshme dhe ekuivalente të parasë të gatshme në fillim të vitit	6	33,737	44,755
Para dhe ekuivalente të parasë më 31 dhjetor (përfshirë rezervën e domosdoshme për likuiditet)	6	35,354	33,737

Pasqyra individuale e rrjedhës së parasë duhet të lexohet në ndërlidhje me shënimet përkatëse që përbëjnë pjesë të pasqyrave financiare individuale në faqet 34 deri 64.

Shënimet për pasqyrat financiare individuale për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2012

1. Informata të përgjithshme

Pronar i 100% të aksioneve të Raiffeisen Bank Kosovo sh.a. (në tekstin e mëtejme 'Banka') është Raiffeisen SEE Region Holding GmbH që është në formë indirekte 100% degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI).

Nga themelimi i Bankës deri në shkurt të vitit 2003, Banka quhej 'Banka Amerikane në Kosovë'. Gjatë shkurtit të vitit 2003, aksionarët e Bankës vendosën ta ndryshojnë emrin e Bankës në Raiffeisen Bank Kosovo sh.a. Ndryshimi i emrit u miratua më 28 prill 2003 nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK, më parë e njohur si Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës – ABPK).

Banka funksionon sipas licencës bankare të lëshuar nga BQK më 8 nëntor 2001. Veprimtaria kryesore bankare është afarizmi bankar retail dhe me biznese brenda territorit të Kosovës.

Më 31 dhjetor 2012, Banka kishte 9 degë dhe 41 nëndegë në Kosovë (më 31 dhjetor 2011 - 9 degë dhe 43 nëndegë). Adresa e regjistruar e Bankës është Rruga UÇK, Nr. 51, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

2. Baza e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe interpretimet e tyre që janë miratuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB).

2.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostove historike, përveç pasqyrave në vijim:

- pasuritë dhe detyrimet financiare janë matur në bazë të vlerës së drejtë,
- pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë matur në bazë të vlerës së drejtë,
- derivatet financiare janë matur në bazë të vlerës së drejtë.

2.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale që Banka ka shfrytëzuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare është euro, e cila është gjithashtu valuta primare të cilën Banka e shfrytëzon në mjedisin ekonomik në të cilin vepron dhe me të cilën e pasqyron substancën ekonomike të veprimtarisë së saj (valuta funksionale). Përveç në rastet kur shprehimisht paraqitet ndryshe, informatat financiare të prezantuara në këtë raport janë në euro dhe janë rumbullakësuar në vlerën e mijëshes më të afërt.

Politikat parimore të kontabilitetit janë përcaktuar në vijim.

3. Politikat kryesore të kontabilitetit

Politikat e kontabilitetit që përshkruhen më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e mbuluara me pasqyrat financiare individuale.

3.1. Kompanitë vartëse dhe konsolidimi

Kompanitë vartëse janë subjekte që kontrollohen nga Banka. Kontrolli ekziston në rastet kur Banka ka autoritet, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për të përcaktuar politikat financiare dhe operative të një entiteti, me qëllim të përfitimit nga veprimtaria e saj. Gjatë vlerësimit të kontrollit shqyrtohen të drejtat potenciale të votimit që mund të ushtrohen.

Këto pasqyra financiare paraqesin pozitën financiare të Bankës si të vetme dhe nuk përfshijnë entitetet vartëse të saj, siç përcaktohet në shënimin 10.

Entitetet amë nuk kanë nevojë që të paraqesin pasqyrat financiare të konsoliduara nëse entiteti amë është edhe vet ndërmarrje vartëse nën pronësi të plotë të ndonjë subjekti tjetër dhe entiteti amë i të njëjtit i paraqet pasqyrat financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe ato i vë në dispozicion të publikut. Banka përgatitë pasqyrat financiare individuale në pajtim me IFRS-në. Interesi në entitete vartëse përlogaritet si kosto në pasqyrat financiare individuale.

3.2. Transaksionet me valuta të huaja

Transaksionet me valuta të huaja regjistrohen sipas normës së këmbimit në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të dhëna në valuta të huaja shndërrohen në vlerat përkatëse në ditën e raportimit dhe sipas normës së këmbimit të ditës në fjalë.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi i valutave të huaja që rezultojnë nga barazimi i transaksioneve të tilla dhe nga shndërrimi i vlerave të pasurive dhe detyrimeve në valuta të huaja në fund të vitit dhe sipas normave të këmbimit valutator të zbatueshme në atë ditë, paraqiten si humbje apo fitim.

Normat zyrtare të këmbimit për valutat kryesore të cilat janë shfrytëzuar për të paraqitur të dhënat në ditën e përgatitjes së raportit janë dhënë në vijim (në euro):

Krahasuar me euro	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
1 USD	0.7570	0.7710
1 CHF	0.8282	0.8190
1 GBP	1.2240	1.1976

3.3. Klasifikimi i pasurive financiare

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë në vijim: pasuritë financiare me vlerë të drejtë sipas fitimit apo humbjes, pasuritë financiare në dispozicion për shitje, investimet e mbajtura drejt maturimit dhe kreditë dhe të arkëtueshmet. Klasifikimi i pasurive financiare përcaktohet me rastin paraqitjes së parë të tyre.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e pasurive financiare përmes rrugëve të rregullta janë paraqitur në datën e tregimit të tyre, d.m.th. në datën kur Banka zotohet ta blejë asetin. Blerjet dhe shitjet përmes rrugëve të rregullta janë blerje apo shitje të pasurive financiare që kërkojnë liferimin e pasurive brenda periudhës së përcaktuar (zakonisht) me rregulloret apo aktet nënligjore të tregut në fjalë.

Fitimet apo humbjet që rrjedhin nga ndryshimi i vlerës për kategorinë 'pasuritë financiare me vlerë të drejtë sipas fitimit apo humbjes' janë përfshirë në fitimin apo humbjen për periudhën gjatë të cilës janë shfaqur. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimi i vlerës së tregut për pasuritë financiare në dispozicion për shitje paraqiten si të ardhura tjera të përgjithshme, deri në largimin apo dështimin e asetit. Në këtë moment, fitimi apo humbja kumulative e paraqitur më parë tek të hyrat tjera të përgjithshme bartet tek fitimi apo humbja e periudhës përkatëse, përmes barazimit. Megjithatë, interesi i kalkuluar duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv, fitimet dhe humbjet nga valutat e huaja në pasuri monetare që janë klasifikuar si në dispozicion për shitje, paraqiten si fitim apo humbje për periudhën përkatëse.

Vlera e drejtë e investimeve të cituara në tregjet aktive bazohet në çmimet aktuale të ofruara për to. Në rast se për një aset financiar nuk ekziston treg aktiv, Banka e përcakton vlerën e drejtë duke i shfrytëzuar teknikat e vlerësimit. Ato shfaqen transaksionet e fundit, analizën e rrjedhës së parash dhe teknikat tjera që rëndom shfrytëzohen nga pjesëmarrësit e tregut.

Investimet dhe pasuritë tjera financiare të Bankës klasifikohen në dy kategoritë në vijim:

3.3.1. Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori ndahet në dy nënkategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregtim (pasuritë e tregimit), përfshirë derivatet e mbajtura, dhe pasuritë financiare të cilave u është përcaktuar vlera e drejtë përmes fitimit apo humbjes në momentin e shfaqjes së tyre. Banka nuk aplikon kontabilitet mbrojtës (eng. hedge accounting).

Pasuritë financiare janë të përcaktuara sipas vlerës së drejtë përmes fitimit apo humbjes kur janë pjesë e një portfoli të ndarë që menaxhohet dhe vlerësohet në bazë të vlerave të drejta, në pajtim me strategjitë e dokumentuara të menaxhimit të riskut apo investimeve. Vlerat e drejta që raportohen zakonisht janë çmimet e verifikueshme të tregut; kryesisht, Banka preferon të investojë në letra me vlerë për të cilat çmimet e tregut mund të vëzhgohen në tregje aktive. Vetëm në situata të rralla ndodh që vlera e drejtë të kalkulohet duke u bazuar në të dhënat që aktualisht mund të vëzhgohen në treg përmes teknikës së vlerësimit.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes fillimisht paraqiten si kosto dhe kostoja e transaksionit (nëse ka të tillë) shënohet si shpenzim që sjell fitim apo humbje. Si rrjedhojë ato barten sipas vlerës së drejtë. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimi i vlerës së tyre në treg paraqiten menjëherë si fitim apo humbje për periudhën në fjalë. Së bashku me interesin e fituar nga instrumentet financiare të cilat përcaktohen sipas vlerës reale të tregut, të njëjtat paraqiten si 'neto rezultati nga pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë, përmes fitimit apo humbjes'. Blerja dhe shitja e pasurive financiare përmes rrugëve të rregullta paraqiten në datën e tregimit të tyre, d.m.th. në datën kur Banka zotohet ta blejë apo shesë asetin në fjalë. Pasuritë financiare me vlerë të drejtë, sipas fitimit apo humbjes largohen kur të drejtat për të pranuar rrjedhë të parave nga pasuritë financiare skadojnë apo kur Banka i ka transferuar substancialisht të gjitha rreziqet apo shpërblimet që ndërliken me pronësinë.

Kjo kategori përbëhet nga dy nënkategori: pasuritë financiare të mbajtura për tregtim, dhe pasuritë të cilave u përcaktohet vlera e drejtë përmes fitimit apo humbjes në momentin e shfaqjes.

Pasuritë financiare klasifikohen si të mbajtura për tregtim në rast se blihen apo shfrytëzohen kryesisht për qëllim të shitjes apo riblerjes në një të ardhme të afërt, apo nëse janë pjesë e një portfolioje instrumentesh financiare që menaxhohen së bashku dhe për të cilët ka dëshmi se janë shfrytëzuar për nxjerrje të fitimeve afatshkurtra. Edhe derivatet kategorizohen si mjete për tregtim, përveç nëse shfrytëzohen si instrumente për kontabilitet mbrojtës.

Pasuritë dhe detyrimet financiare ndahen sipas vlerës së drejtë përmes fitimit apo humbjes kur:

- o Realizimi i kësaj i zvogëlon dukshëm moskonsistencat në matje të cilat do të shfaqeshin në rast se instrumentet e ndërlihdura do të trajtoheshin si të mbajtura për tregtim dhe nëse instrumentet financiare që qëndrojnë prapa tyre barten sipas koston së amortizuar për kredi dhe paradhënie për klientë apo banka dhe fletëobligacione të emetuara;
- o Disa investime të caktuara, siç janë investimet kapitale, të cilat menaxhohen dhe vlerësohen në bazë të vlerës së drejtë në pajtim me strategjinë e dokumentuar të menaxhimit të riskut dhe investimeve dhe i raportohen menaxhmentit si të tilla, rregullohen me vlerë të drejtë sipas fitimit dhe humbjes; dhe
- o Instrumentet financiare, si janë fletëobligacionet e mbajtura, që përmbajnë një apo më shumë derivate që ndikojnë dukshëm në rrjedhën e parasë, rregullohen sipas vlerës së drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimi i vlerës së derivateve që menaxhohen në ndërthurje me pasuritë financiare apo detyrimet financiare përfshihen në të ardhurat neto nga pasuritë financiare të rregulluara sipas vlerës së drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

3.3.2. Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Pasuri në dispozicion për shitje janë ato pasuri që pritet të mbahen për periudha të pakufizuara kohore, të cilat mund të shiten për të përmbushur nevojat e likuiditetit apo ndryshimeve të normave të interesit, normave të këmbimit valutor apo çmimeve të kapitalit.

Gjatë regjistrimit të parë, pasuritë financiare në dispozicion për shitje regjistrohen sipas vlerës së drejtë të cilës i shtohen shpenzimet e transaksionit (nëse ka të tilla). Rrjedhimisht, ato regjistrohen sipas vlerës së drejtë. Vlerat e drejta që raportohen janë ose çmime të verifikueshme të tregut ose vlera të kalkuluara përmes teknikave të vlerësimit të tregut. Për pasuritë afatshkurtra, vlerësohet se vlera e tyre e drejtë më së miri pasqyrohet në vetë çmimin e transaksionit. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimi i vlerës së drejtë së pasurive financiare në dispozicion për shitje regjistrohen përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, nën pikën 'rezerva të tjera', deri në momentin e çregjistrimit apo rënies në vlerë të asetit financiar. Në këtë moment, fitimi apo humbja kumulative e paraqitur më parë tek të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse bartet tek fitimi apo humbja përmes metodës së barazimit. Interesi i kalkuluar sipas metodës së normës së interesit efektiv dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore të pasurive monetare që klasifikohen si në dispozicion për shitje paraqiten si fitim apo humbje. Dividendat nga instrumentet kapitale në dispozicion për shitje, nëse ka të tilla, paraqiten si fitim apo humbje kur të përcaktohet e drejta e entitetit për ta pranuar pagesën.

Blerja dhe shitja e pasurive financiare në dispozicion për shitje regjistrohet në ditën e tregimit. Pasuritë financiare në dispozicion për shitje largohen nga regjistrat kur të skadojnë të drejtat për të pranuar para nga pasuritë financiare gjegjëse dhe kur Banka ka bartur në mënyrë substancialë të gjitha rreziqet dhe përfitimet që ndërliken me pronësinë e tyre.

3.3.3. Kreditë dhe paradhëniet për klientë

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare joderivative me pagesa fikse ose të parapërcaktuara të cilat nuk citohen në tregun aktiv. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet fillimisht paraqiten sipas vlerës së drejtë, duke qenë se kemi të bëjmë me para të gatshme që u jepen huamarrësve. Pas regjistrimit fillestar, ato maten sipas kostove të amortizuara, duke shfrytëzuar metodën e normës së interesit efektiv. Kostoja e amortizuar kalkulohet duke marrë parasysh kostot e lëshimit dhe të gjitha lirimet apo primet pas barazimit.

Kreditë dhe paradhëniet raportohen neto pa provizionet për humbje kreditore.

3.3.4. Investimet e mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë investimet në bono qeveritare që Banka mëton dhe ka mundësi që t'i mbajë deri në maturimin e tyre. Si rezultat i këtij qëllimi, ato klasifikohen si pasuri që mbahen deri në maturim.

3.3.5. Investimet me vlerë të drejtë sipas fitimit dhe humbjes

Instrumentet klasifikohen si me vlerë të drejtë sipas fitimit dhe humbjes nëse ato mbahen për tregtim apo përcaktohen si të tilla në momentin e regjistrimit të parë. Instrumentet financiare përcaktohen si të tilla nëse Grupi i menaxhon këto investime dhe merr vendimet për blerje dhe shitje në bazë të vlerës së tyre të drejtë. Pas regjistrimit fillestar, kostot e transaksionit paraqiten në të dhënat e fitimit apo humbjes në momentin e shfaqjes së tyre. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë sipas fitimit apo humbjes maten sipas vlerës së drejtë, ndërsa ndryshimet e kësaj vlere regjistrohen tek fitimi apo humbjet.

3.3.6. Instrumentet financiare balancuese

Pasuritë dhe detyrimet financiare balancohen dhe vlera neto e raportuar në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme kur ekziston e drejtë ligjore për të kryer balancimin e vlerave të regjistruara dhe kur ekziston qëllimi që barazimi të kryhet në baza neto, ose që të realizohet asetit dhe të mbulohet detyrimi njëkohësisht.

3.3.7. Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e tregut apo çmimet e dhëna nga shitësit për instrumentet financiare që tregtohen në tregje aktive. Për të gjitha instrumentet tjera, vlera e drejtë përcaktohet duke shfrytëzuar teknikat e vlerësimit. Teknikat e vlerësimit ngërthejnë teknikat e vlerës aktuale, metodën e rrjedhës së parasë së zbritur, krahasimin me instrumente tjera të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të tregut, si dhe modelet e vlerësimit.

Banka i matë vlerat e drejta duke e shfrytëzuar hierarkinë vijuese të vlerave të tregut, që reflekton rëndësinë e inpleteve të shfrytëzuara gjatë realizimit të matjes:

Niveli 1: Çmimi i tregut (i parregulluar) në tregun aktiv për një instrument identik.

Niveli 2: Teknikat e vlerësimit që bazohen në inplete të verifikueshme, qoftë drejtpërdrejtë (d.m.th. përmes çmimeve) ose tërthorazi (d.m.th. që derivojnë nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumentet që vlerësohen duke shfrytëzuar: çmimet e dhëna të tregut për instrumente të ngjashme në tregjet aktive; çmimet e dhëna për instrumente identike apo të ngjashme në tregjet që konsiderohen më pak se aktive; apo teknikat tjera të vlerësimit kur të gjitha inputet e rëndësishme janë të verifikueshme drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: Teknikat e vlerësimit duke shfrytëzuar inplete të rëndësishme të paverifikueshme. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet ku teknika e vlerësimit përfshin inplete të cilat nuk bazohen në të dhëna të verifikueshme dhe ku inputet e paverifikueshme kanë ndikim të theksuar në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen në bazë të çmimeve të dhëna për instrumente të ngjashme, me ç'rast nevojiten përmirësime apo supozime të paverifikueshme për të mbuluar dallimin mes instrumenteve të fjalë.

Banka shfrytëzon modele të mirënjohura të vlerësimit për caktimin e vlerës së drejtë për instrumente të rëndomta dhe më të thjeshta financiare. Për këto instrumente, të dhënat që shfrytëzohen nga modeli janë të verifikueshme në treg. Teknikat e vlerësimit përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto dhe rrjedhës së parasë së zbritur, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime të verifikueshme në treg dhe bazuar në lakoren aktuale të rendimentit që është adekuate për pjesën e mbetur deri tek maturimi. Qëllimi i teknikave të vlerësimit është që të nxirret vlera e drejtë që pasqyron çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, e i cili do të përcaktohej nga pjesëmarrësit në treg gjatë funksionimit të rëndomtë të tyre.

Vlera e drejtë e parave të gatshme dhe ekuivalenteve të tyre, kredive dhe paradhënieve për banka është përafërsisht i njëjtit me vlerën bartëse, për shkak të maturimit afatshkurtër të tyre. Vlera e drejtë për kredi dhe paradhënie për klientë është përafërsisht e barabartë me vlerën e tyre për shkak të faktit se pjesa më e madhe e portfolios së kredive jepet me norma lëvizëse të interesit të cilat pasqyrojnë ndryshimet e rethanave në treg.

3.4. Derivatet financiare

Derivatet fillimisht regjistrohen sipas vlerës së drejtë në datën e lidhjes së kontratës për to dhe më pas maten sipas vlerës reale të tregut. Vlerat e tregut merren përmes çmimeve të marra nga tregjet aktive, përfshirë transaksionet e kohës së

fundit, dhe përmes teknikave të vlerësimit, përfshirë modelet e vlerës së zbritur të parasë së gatshme, kurdo që ato mund të shfrytëzohen. Të gjitha derivatet barten si pasuri kur vlera e tyre e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e tyre e drejtë është negative. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimi i vlerës së drejtë të derivateve përfshihen në kaptinën e 'fitimit dhe humbjes nga letrat investive me vlerë' në fitimin apo humbjen e periudhës gjegjëse.

Banka shfrytëzon derivate financiare siç janë opsionet e normave të interesit OTC dhe kontratat për sigurim të valutave të huaja, për t'iu shmangur rrezikut të cilit do t'i nënshtrohej në rast të lëkundjes së normave të interesit apo kursit të këmbimit të valutave të huaja. Për derivatet financiare nuk zbatohet kurrfarë kontabiliteti mbrojtës. Derivatet financiare fillimisht regjistrohen sipas vlerës së tyre të drejtë në ditën e lidhjes së kontratës për to, ndërsa më pas maten sipas vlerës së tregut dhe ndryshimi i kësaj vlere të tregut regjistrohet si fitim apo humbje.

3.5. Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet për to

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet gjegjëse për të gjitha instrumentet financiare që bartin interes regjistrohen në fitimin dhe humbjen për periudhën përkatëse si 'të ardhura nga interesi' dhe 'shpenzim për interes', duke shfrytëzuar metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është metodë për kalkulimin e kostos së amortizuar të një asetit financiar apo detyrimin financiar përkatës dhe për alokimin e të ardhurave nga interesi apo shpenzimeve për interes gjatë periudhës së caktuar. Norma e interesit efektiv është norma që në mënyrë të saktë zbret pagesat apo të arkëtueshme e ardhshme në formë të parave të gatshme përgjatë tërë jetëgjatësisë së pritur të instrumentit financiar, apo (kurdo që është e rrugës) për një periudhë më të shkurtër, nga vlera e bartur e asetit financiar apo detyrimit financiar. Gjatë kalkulimit të normës së interesit efektiv, Banka parashikon rrjedhën e parasë duke i shqyrtuar të gjitha kushtet kontraktuese të instrumenteve financiare, por nuk i konsideron fare humbjet e ardhshme kreditore. Ky kalkulim përfshin të gjitha tarifatat dhe pikët e paguara apo pranuar mes palëve të kontratës që përbëjnë pjesë integrale të normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe të gjitha primet apo zbritjet tjera.

Pasi që një aset financiar apo një grup i pasurive të ngjashme financiare të jenë shlyer si rezultat i humbjes nga rënia në vlerë, të ardhurat nga interesi regjistrohen duke e shfrytëzuar normën e interesit të shfrytëzuar për të zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë me qëllim të matjes së humbjes nga rënia në vlerë.

3.6. Të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet

Tarifatat dhe komisionet kryesisht regjistrohen në bazë të grumbullimit të tyre pas ofrimit të shërbimit. Paraqitja e tarifave për zotim për kreditë të cilat kanë gjasa të tërhiqen shtyhet për fazat tjera (si edhe kostot tjera drejtpërdrejt të ndërlidhura) dhe paraqiten si përshtatje e normës së interesit efektiv për kreditë në fjalë.

3.7. Rënia në vlerë e pasurive financiare

Rënia në vlerë e kredive dhe paradhënieve

Banka vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ekzistojnë dëshmi objektive se një aset financiar apo një grup i pasurive financiare është dëmtuar. Pasuritë financiare apo grupet e pasurive financiare konsiderohen të rëna në vlerë vetëm kur ekzistojnë dëshmi objektive të rënies së tillë në vlerë, si rezultat i një apo më shumë zhvillimeve që kanë ngjarë pas regjistrimit fillestar të asetit (humbje) apo nëse humbja (apo humbjet) në fjalë kanë ndikuar në rrjedhën e parave që është parashikuar për asetin financiar apo grupin e pasurive financiare, sipas parashikimeve objektive.

Kriteret që Banka i shfrytëzon për të përcaktuar nëse ekzistojnë dëshmi objektive mbi ndonjë humbje si pasojë e rënies në vlerë janë, mes tjerash:

- Dështimi në kryerjen e pagesave kontraktuale të kryegjësë apo interesit;
- Hasja e vështirësive në rrjedhë të parasë nga huamarrësi;
- Shkelja e dispozitave apo kushteve të kredisë;
- Inicimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësimi i aftësive konkurruese të huamarrësit;
- Rënia e vlerës së pengut;

Hapësira kohore e supozuar mes shfaqjes së humbjeve dhe identifikimit të tyre përcaktohet nga menaxhmenti lokal për secilën portfolio të caktuar. Në përgjithësi, këto periudha dallojnë dhe janë mes 3 dhe 12 muaj; në raste të veçanta, shfrytëzohen edhe periudha më të gjata.

Banka fillimisht vlerëson nëse ekzistojnë dëshmi objektive mbi rënien në vlerë të pasurive financiare individuale e të cilat janë të rëndësishme individualisht, apo mbi rënien në vlerë në mënyrë individuale apo kolektive të pasurive financiare e që nuk janë të rëndësishme individualisht. Nëse Banka përcakton se nuk ekzistojnë dëshmi objektive për rënie në

vlerë të një asetit financiar individualisht të vlerësuar, qoftë ai i rëndësishëm apo jo, ajo e përfshin asetin në fjalë në grupin e pasurive me karakteristika të ngjashme të rrezikut, të cilat i vlerëson për rënie në vlerë në mënyrë kolektive. Pasuritë të cilat vlerësohen për rënie në vlerë në mënyrë individuale, e tek të cilat humbjet nga dështimet regjistrohen apo vazhdojnë të shfaqen, nuk përfshihen në vlerësimin kolektiv të dështimeve.

Vlera e humbjes matet si dallimi mes vlerës së bartur prej asetit dhe vlerës aktuale të rrjedhës së parashikuar të parasë (përjashtuar humbjet e ardhshme kreditore të cilat nuk janë përlogaritur) e cila zbritet në normën e interesit efektiv fillestar të asetit financiar. Vlera e bartur prej asetit zvogëlohet përmes shfrytëzimit të një llogarie për kompensime, ndërsa vlera e humbjes regjistrohet tek fitimi dhe humbjet.

Kalkulimi i vlerës aktuale të rrjedhës së parashikuar të parasë për pasuri financiare me peng, pasqyron rrjedhën e parasë që mund të rezultojë nga konfiskimi i pengut, minus kostot për marrjen dhe shitjen e pengut, pa marrë parasysh nëse konfiskimi i pengut ka gjasa të ndodhë apo jo.

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të rënies në vlerë, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme sa i përket rrezikut kreditor (d.m.th. në bazë të procesit të rangimit të Bankës, i cili shfrytëzon llojin e asetit, industrinë, lokacionin gjeografik, llojin e pengut, statusin e huave të kaluara dhe faktorë tjerë relevantë). Këto karakteristika janë relevante për supozimin e rrjedhës së parasë në të ardhmen për grupe të pasurive të tilla, duke dhënë indikacione mbi aftësinë e debitorëve për t'i paguar të gjitha vlerat sipas kushteve të kontratës për pasuritë në vlerësim.

Rrjedha e ardhshme e parasë për grupe të pasurive financiare që kolektivisht vlerësohen për rënie në vlerë parashikohet në bazë të rrjedhave të parasë për pasuri të ngjashme në Bankë dhe në bazë të përvojës me humbje për pasuri me karakteristika të ngjashme kreditore me ato të Bankës. Përvoja me humbje në të kaluarën përshtatet në bazë të të dhënave të verifikueshme aktualisht për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk kanë pasur ndikim në periudhën të cilës i referohet përvoja me humbje dhe për t'i shmangur efektet e kushteve që kanë ekzistuar në të kaluarën por që nuk ekzistojnë më. Parashikimet e ndryshimit të rrjedhës së ardhshme të parasë për grupe pasurish pasqyrojnë dhe janë drejtpërsëdrejti të ndërlidhura me ndryshimet e kohëpaskohshme të të dhënave të verifikueshme (për shembull, ndryshimet e normës së papunësisë, çmimeve të pronave, statusit të pagesave dhe faktorëve të tjerë që dëshmojnë se mund të ndryshojë probabiliteti i humbjeve dhe shkalla e tyre për Bankën). Metodologjia dhe supozimet e shfrytëzuara për të parashikuar rrjedhat e ardhshme të parasë rishikohen rregullisht nga Banka me qëllim të zvogëlimit të dallimeve mes parashikimeve të humbjes dhe humbjeve reale.

Kur një kredi nuk inkasohet, ajo shlyhet kundrejt provizionit përkatës për rënie në vlerë kreditore. Kreditet e tilla shlyhen pasi që të jenë kryer të gjitha procedurat e domosdoshme dhe pasi që të jetë përcaktuar vlera e humbjes së pësuar.

Nëse, në një periudhë vijuese, vlera e humbjes nga rënie në vlerë zvogëlohet dhe ky zvogëlim mund të ndërlidhet objektivisht me një ngjarje që është zhvilluar pas regjistrimit të rënies në vlerë (siç është përmirësimi i rangimit kreditor të debitorit), humbjet paraprake nga rënie në vlerë që janë regjistruar përmirësohen duke bërë përshtatjet përkatëse në llogarinë e kompensimit. Vlera e kthyer regjistrohet në fitime dhe humbje si tarifë për humbjet kreditore.

(b) Rënia në vlerë e pasurive financiare në dispozicion për shitje

Banka e vlerëson më secilën datë raportimi nëse ekzistojnë dëshmi objektive se një aset financiar apo një grup i pasurive financiare është dëmtuar. Në rast të investimeve në hua që klasifikohen si në dispozicion për shitje, gjatë vlerësimit nëse një aset është i rënë në vlerë konsiderohet rënia e dukshme apo më e gjatë e vlerës së drejtë të sigurimit nën koston e saj. Nëse ekzistojnë dëshmi të tilla për pasuritë financiare në dispozicion për shitje, humbja kumulative, e matur si dallimi mes koston së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus humbjet për rënie në vlerë që për asetin financiar janë regjistruar më parë tek fitimi dhe humbjet, largohet nga të ardhurat tjera të përgjithshme dhe vendoset tek fitimi apo humbja. Nëse më vonë vlera e drejtë e instrumentit të klasifikuar si në dispozicion për shitje rritet dhe rritja e tillë mund të ndërlidhet në mënyrë objektive me ndonjë zhvillim që ka ngjarë pas paraqitjes së fitimit apo humbjes, humbja nga rënia në vlerë kthehet prapa përmes fitimit dhe humbjes.

3.8. Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e tyre

Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e tyre janë njësi që mund të konvertohen në para të gatshme për periudha të shkurtra kohore (me maturim prej më pak se tre muajsh) dhe të cilat nuk i nënshtrohen ndonjë risku të theksuar nga ndryshimi i vlerave. Shumat që ndërlidhen me fonde që për nga natyra janë të kufizuara zakonisht përjashtohen nga kategoria e parave të gatshme dhe ekuivalenteve të tyre.

3.9. Rezervat e domosdoshme për likuiditet

Në pajtim me rregullat e BQK-së, Banka duhet t'i përmbahet kushtit për likuiditet mesatar minimal. Kushti i likuiditetit kalkulohet në baza javore në bazë të 10 për qind të bazës së depozitave, që definohet si mesatarja e detyrimeve të përgjithshme për depozita e auditorit jobankar në euro dhe valuta tjera gjatë ditëve të punës për periudhën raportuese.

Pasuritë me të cilat Banka duhet ta plotësojë kushtin e likuiditetit janë depozitat në euro me BQK-në dhe 50 për qind me ekuivalente të parave të gatshme në euro të denominuara si valuta që janë të gatshme për këmbim. Depozitat tek BQK duhet të jenë jo më të ulëta se 5 për qind e bazës së depozitave aktuale. Duke qenë se pasuritë likuide në fjalë Banka nuk i ka në dispozicion për të realizuar veprimtarinë ditore të saj, ato nuk përfshihen në pasqyrat financiare të parave të gatshme dhe ekuivalenteve të tyre.

3.10. Derivatvët financiar të mbajtura për qëllime të menaxhimit të riskut

Derivatvët financiar të mbajtura për qëllim të menaxhimit të riskut përfshijnë të gjitha pasuritë dhe detyrimet e derivuara të cilat nuk klasifikohen si pasuri apo detyrime tregtare. Derivatvët financiar të mbajtura për qëllime të menaxhimit të riskut maten sipas vlerës së drejtë në datën e raportimit.

3.11. Përmirësimet e objekteve me qira dhe pajisjet

Shpenzimet për përmirësime të objekteve me qira dhe pajisje deklarohen sipas kostove nga e kaluara, minus amortizimi i akumuluar dhe dëmtimet e akumuluar (nëse ka të tilla). Kostoja nga e kaluara përfshin shpenzimet të cilat janë drejtpërdrejt të atribueshme për blerjen e shërbimeve për përmirësime në objekte me qira dhe për pajisje.

Kostot për to përfshihen në vlerën e bartur nga asetit ose regjistrohen si aset i veçantë, varësisht nga situata, vetëm kur ka mundësi që përfitimet e ardhshme ekonomike të ndërlihdura me njësinë në fjalë do t'i rrjedhin Bankës dhe kur kostoja e njësisë mund të matet në mënyrë të qëndrueshme. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera regjistrohen tek shpenzimet tjera operative gjatë periudhës financiare gjatë të cilës shfaqen.

Vlerat që i bartin përmirësimet e objekteve me qira dhe pajisjet shqyrtohen për të vlerësuar nëse ka pasur dëmtime në raste kur ndryshimi apo ndryshimet e rrethanave japin indikacion se vlera e bartur mund të jetë e pakthyeshme. Në rast se ekzistojnë indikacione të tilla dhe në rast se vlerat e bartura janë më të larta se sa vlera e kthyeshme, pasuritë apo njësitë që gjenerojnë para të gatshme shlyhen në bazë të vlerës që mund ta kthejnë.

Vlera e kthyeshme e përmirësimeve të objekteve me qira dhe pajisjeve është më e lartë se sa vlera e drejtë, minus kostot e shitjes dhe vlera e shfrytëzimit. Gjatë vlerësimit të vlerës së shfrytëzimit, duhet të zbriten parashikimet e rrjedhës së ardhshme të parasë sipas vlerës aktuale të tyre, duke shfrytëzuar normën e zbritjes para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut, vlerën e parave dhe rreziqet specifike të pasurive.

Për një aset që nuk gjeneron rrjedha të pavarura dhe të mëdha parash, vlera e kthyeshme përcaktohet për njësinë që gjeneron para të gatshme të cilës i përket asetit. Humbjet nga rëniet në vlerë regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme.

Zhvlërësimi i pasurive bëhet në baza lineare, sipas normave të parapërcaktuara, me qëllim të alokimit të kostos së pronës dhe pajisjeve përgjatë jetëgjatësisë së dobishme të tyre. Normat vjetore të zhvlërësimit përcaktohen në bazë të parashikimit për dobishmërinë e tyre, sipas tabelës në vijim:

Përmirësimet në objekte me qira zhvlërësohen në bazë të dobishmërisë së tyre dhe kohëzgjatjes së qirasë.

Bankomatet, pajisjet tjera bankare dhe të zyrave dhe serverët e TI-së	5 vjet
Hardueri kompjuterik	3 vjet

Metodat e zhvlërësimit, dobishmëria dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

3.12. Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme pasqyrohen nëse ka gjasa se Banka do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen të cilat do të mund t'i atribuohen asetit në fjalë dhe nëse kostoja e asetit mund të matet në mënyrë të besueshme. Pasuritë e paprekshme maten fillimisht në bazë të kostos. Vlerat e bartura të pasurive të paprekshme rishikohen për të identifikuar rëniet në vlerë në raste kur ndonjë zhvillim apo ndryshim i rrethanave jep indikacion se vlerat e bartura mund të mos jenë të kthyeshme. Pasuritë e paprekshme përbëhen nga softueri kompjuterik, i cili amortizohet sipas metodës lineare përgjatë tërë jetëgjatësisë së tyre prej pesë vitesh dhe licencat të cilat amortizohen përgjatë kohëzgjatjes së tyre.

3.13. Pronat e riposeduara

Në disa rrethana, pronat kthehen në posedim pas sekuestrimit të tyre për shkak të kredive të pakthyesha. Pronat e kthyesha në posedim regjistrohen nën 'Pasuritë tjera' me vlerë prej 1.000 euro. Qëllimi i menaxhimit është që pronat e riposeduara t'i shesë sa më shpejtë që të jetë e mundur, ndërsa të hyrat nga shitja t'i shfrytëzojnë për ta mbuluar kthimin e pjesës së mbetur të borxhit.

3.14. Huazimet

Huazimet fillimisht regjistrohen si kosto neto, pa i përfshirë kostot e transaksionit. Huazimet më pas shënohen si kosto të amortizuara; çdo dallim me të hyrave neto pa kosto të transaksionit dhe vlerës së kthyer shënohet si fitim apo humbje gjatë periudhës së huazimit, duke e shfrytëzuar metodën e interesit efektiv.

3.15. Provizionet

Provizionet për pretendime juridike regjistrohen kur: Banka ka ndonjë obligim juridik momental apo si rrjedhojë e ngjarjeve nga e kaluara; kur ka mundësi që të nevojiten resurse shtesë për ta paguar obligimin; dhe kur vlera mund të parashikohet në mënyrë të besueshme. Provizionet shënohen edhe nëse gjasat e shfaqjes së ndonjë obligimi janë të vogla.

Provizionet maten sipas vlerës aktuale të shpenzimeve të pritura për të mbuluar obligimin, duke shfrytëzuar normën para tatimit që pasqyron vlerësimin aktual të tregut në kuptim të vlerës aktuale të parasë, si dhe rreziqet specifike për obligimin në fjalë. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të kohës regjistrohet si shpenzim interesi.

Garancitë dhe zotimet siç janë mosshfrytëzimi i marrëveshjeve kreditore, duhet regjistruar në rast se janë formalisht obligative dhe nuk përbëjnë thjeshtë limite të brendshme. Garancitë dhe zotimet mund të zhvillohen në mënyra që nuk mund të parashikohen në momentin e përcaktimit të tyre. Për këtë arsye, ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse ka gjasa që resurse të caktuara të shfrytëzohen për përfitime ekonomike. Në rast se garancitë dhe zotimet rezultojnë me obligime aktuale të cilat mund të maten në mënyrë të besueshme, duhet të bëhet balancimi i provizionit. Vetëm zotimet e parevokueshme rezultojnë me rritje të rrezikut kreditor, andaj vetëm zotimet dhe garancitë mund t'i nënshtrohen provizionimit. Në rast të ekspozimeve më të mëdha, vlerësimi duhet të bëhet individualisht. Në rast të vlerësimeve për portfolio, ndërtimi i portfolios dhe kalkulimi i provizioneve për portfolio duhet të bëhet sipas përcaktimeve për rëniet në vlerë të kredive dhe paradhënieve.

3.16. Beneficionet e punonjësve

Banka e paguan vetëm kontributin pensional publik, i cili është i obligueshëm. Banka nuk ka kurrfarë obligime të tjera përveç pagimit të kontributeve në fjalë. Kontributet pasqyrohen si shpenzime për beneficione të punonjësve në momentin e pagimit të tyre.

3.17. Qiratë operative

Pagesat e bëra në emër të qirave operative paguhet nga shpenzimet në baza lineare përgjatë tërë kohëzgjatjes së qirasë. Kur një qira operative ndërpritet para skadimit të kohëzgjatjes së qirasë, të gjitha pagesat që duhet t'i bëhen qiradhënësit në formë penalltish paraqiten si shpenzime për periudhën deri në skadim.

3.18. Tatimi në të ardhura

Shpenzimet për tatim në të ardhura përbëhen nga tatimet aktuale dhe tatimet e shtyra. Shpenzimet për tatim në të ardhura paraqiten në deklaratën individuale të të ardhurave të përgjithshme, përveç kur kanë të bëjnë me njësi të paraqitura drejtpërdrejt në kapital, kur i njëjti paraqitet si pjesë e kapitalit. Tatimet aktuale janë tatimet që pritet të paguhet për të ardhurat e tatueshme për vitin, duke i shfrytëzuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe të gjitha përshtatjet e tatimeve të pagueshme gjatë viteve të kaluara.

Tatimet e shtyra mbulohen duke e shfrytëzuar metodën e bilancit të gjendjes, duke mbuluar dallimet e përkohshme mes vlerës aktuale të pasurive dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të shfrytëzuara për qëllime tatimore. Tatimet e shtyra kullohen në bazë të normave tatimore që pritet të aplikohen mbi dallimet e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, në bazë të ligjeve të zbatueshme apo në fuqi në datën e raportimit.

Pasuritë me tatim të shtyrë paraqiten vetëm në rast se ka gjasa që të ketë profite të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen dallimet e përkohshme të zbritshme. Detyrimet për tatim të shtyrë rishikohen çdo herë në datën e raportimit dhe zvogëlohen deri në atë masë që të mos jetë më e mundshme që të realizohen përfitime tatimore përkatësisht obligime tatimore.

Tatimi në të ardhura shtesë që rrjedhin nga shpërndarja e dividendave paraqitet njëkohësisht me shfaqjen e obligimit për t'i paguar dividendat gjegjëse.

3.19. Kapitali aksionar

Dividendat për aksione të rëndomta paraqiten në kapital në periudhën në të cilën janë miratuar nga aksionarët e Bankës.

3.20. Miratimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

(a) Standardet dhe interpretimet e zbatueshme për periudhën aktuale

Amendamentet vijuese të standardeve ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raporteve Financiare janë të zbatueshme për periudhën aktuale:

- Amendamentet e IFRS 1 "Adaptimi i IFRS për herë të parë" – Hiperinflacioni i rëndë dhe largimi i datave fikse për entitetet që adaptojnë për herë të parë (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2011),
- Amendamentet e IFRS 7 "Instrumentet financiare: zbulimi i informatave" – Transferi i pasurive financiare (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2011),
- Amendamentet e IAS 12 "Tatimi në të ardhura" – Tatimi i shtyrë: Kithimi i pasurive të ndërlidhura (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2012).

Adaptimi i këtyre amendamenteve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka rezultuar me ndryshime të politikave kontabile të Bankës, të pasqyrave financiare të saj apo të performansës së saj.

(b) Standardet dhe interpretimet e pazbatueshme në momentin e nxjerrjes së raportit

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, revizionet dhe interpretimet vijuese ishin miratuar por ende nuk kishin hyrë në fuqi. Asnjë prej tyre nuk pritet të ketë ndikim të theksuar në pasqyrat financiare të Bankës.

- **IFRS 9 "Instrumentet financiare"** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2015), Është publikuar nga IASB më 12 nëntor 2009. Më 28 shtator 2010, IASB e nxori propozimin IFRS 9, duke i inkuorporuar kërkesat e reja për përllogaritje të detyrimeve financiare dhe duke i bartur nga IAS 39 kërkesat për mosparaqitje të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare. Ky standard shfrytëzon një qasje të vetme për të përcaktuar nëse pasuritë financiare maten sipas kostove të amortizuara apo vlerës së drejtë, duke zëvendësuar kështu shumëllojshmëri rregullash të ndryshme nga IAS 39. Qasja në IFRS 9 bazohet në atë se si entiteti menaxhon instrumentet e veta financiare (modelin e vet afarist) dhe karakteristikat e pasurive financiare në kuptim të rrjedhës së parave. Standardi i ri gjithashtu kërkon që të shfrytëzohet një metodë e vetme e përcaktimit të rënies në vlerë, duke i zëvendësuar shumë metoda përkatëse që ofroheshin sipas IAS 39. Kërkesat e reja për përllogaritje të detyrimeve financiare adresojnë problemin e lëkundjes së fitimit ose humbjes që shfaqet në rast se lëshuesi vendos që borxhin e vet ta matë në bazë të vlerës së drejtë. IASB ka vendosur që për shumicën e detyrimeve të shfrytëzohet matja aktuale e kostos së amortizuar, duke kufizuar ndryshimet për të mbuluar vetëm adresimin e problemit vetanak me kredi. Në bazë të kërkesave të reja, entiteti që zgjedh që detyrimet t'i matë sipas vlerës së drejtë do ta paraqesë një pjesë të ndryshimit në vlerën e drejtë për shkak të ndryshimeve të riskut kreditor të vetë dhënësit në kaptinën për të ardhurat tjera të përgjithshme të pasqyrës individuale për të ardhurat e përgjithshme dhe jo brenda pjesës së fitimit dhe humbjeve.
- IFRS 10 "Pasqyrat e konsoliduara financiare" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- IFRS 11 "Aranzhimet e përbashkëta" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- IFRS 12 "Zbulimi i përfshirjes në entitete tjera" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- IFRS 13 "Matja e vlerës së drejtë" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- IAS 27 (e rishikuar në vitin 2011) "Pasqyrat financiare individuale" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- IAS 28 (e rishikuar në vitin 2011) "Investimet në ortakëri dhe shoqëri aksionare" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- Amendamentet e IFRS 1 "Adaptimi i IFRS për herë të parë" – Hiperinflacioni i rëndë dhe largimi i datave fikse për entitetet që adaptojnë për herë të parë (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2011),
- Amendamentet e IFRS 7 "Instrumentet financiare: zbulimi i informatave" – Transferi i pasurive financiare (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2011),
- Amendamentet e IFRS 9 "Instrumentet financiare" dhe IFRS 7 "Instrumentet Financiare: Zbulimi i Informatave" – Data obligative e hyrjes në fuqi dhe zbulimet transitorë,
- Amendamentet e IFRS 10 "Pasqyrat e konsoliduara financiare", IFRS 11 "Aranzhimet e përbashkëta" dhe IFRS 12 "Zbulimi i interesit në entitete tjera" – Udhëzime për tranzicion (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- Amendamentet e IFRS 10 "Pasqyrat e konsoliduara financiare", IFRS 12 "Zbulimi i interesit në entitete tjera" dhe IAS 27 "Pasqyrat financiare individuale" – Entitetet investive (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2014),
- Amendamentet e IAS "Paraqitja e pasqyrave financiare" – Paraqitjet e njësive të të ardhurave tjera të përgjithshme (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2012),
- Amendamentet e IAS 19 "Beneficionet e punonjësve" – Përmirësime në përllogaritjen e beneficioneve pas punësimit (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- Amendamentet e IAS 32 "Instrumentet financiare: prezantimi" – Balancimi i pasurive financiare dhe detyrimeve

- financiare (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2014),
- Amendamentet e standardet të ndryshme "Përmirësime të IFRS-ve (2012)" që rezultojë nga projekti vjetor për përmirësimin e IFRS-ve, të publikuar më 17 maj 2012 (IFRS 1, IAS 1, IAS 16, IAS 32, IAS 34) parimisht me qëllim të largimit të moskonsistencave dhe qartësimi të terminologjisë (amendamentet do të jenë të zbatueshme për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013),
- IFRIC 20 "Heqja e shpenzimeve në fazën e prodhimit të minierave sipërfaqësore" (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2013).

Banka ka vendosur që të mos i miratojë këto standarde, revizione dhe interpretime para hyrjes së tyre në fuqi. Banka parashikon se miratimi i këtyre standardeve, revizioneve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e zbatimit fillestar të tyre.

3.21. Parashikimet dhe gjykimet kryesore kontabilare

Banka i bën supozimet dhe parashikimet e veta që kanë ndikim në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit vijues financiar. Parashikimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, përfshirë ngjarjet që besohet se do të ndodhin në të ardhmen.

a) Tarifa e rënies në vlerë për humbje kreditore

Banka e shqyrton portfolion e kredive të saj për të vlerësuar rënien në vlerë, së paku çdo tre muaj. Gjatë përcaktimit nëse një humbje nga rënia në vlerë do duhej të regjistrohet në pjesën e fitimit apo humbjes, Banka gjykimin e vet e bën duke vlerësuar nëse ka në dispozicion të dhëna të verifikueshme që tregojnë se do të ketë zvogëlim të matshëm të rrjedhës së parave nga portfolio i kredive në të ardhmen e afërt, para se që zvogëlimi të mund të identifikohet në ndonjë kredi individuale brenda portfolios. Kjo dëshmi mund të jetë në formë të të dhënave të verifikueshme që tregojnë se ka pasur ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve të Bankës, ose se rrethanat e ekonomisë kombëtare apo lokale mund të ndërlidhen me rënie në vlerë të pasurive të Bankës.

Menaxhmenti i përdorë parashikimet në bazë të përvojës nga e kaluara me humbje për pasuri me karakteristika të ngjashme kreditore dhe me dëshmi të ngjashme për rënie në vlerë potenciale, gjatë përcaktimit të rrjedhës së parasë për të ardhmen. Kjo metodologji dhe parashikimet e shfrytëzuara për parashikimin e shumës dhe kohës së rrjedhës së parasë rishikohen rregullisht për t'i zvogëluar dallimet mes humbjeve të parashikuara dhe humbjeve aktuale.

b) Rënia në vlerë e investimeve në dispozicion për shitje

Banka përcakton se investimet e gatshme për shitje janë rënë në vlerë kur shënohet rënie e dukshme apo e zgjatur e vlerës së drejtë të tyre, në nivel nën koston e tyre. Përcaktimi se çka përbën rënie të dukshme apo të zgjatur është çështje e gjykimit të tyre. Gjatë arritjes deri tek ky gjykim, Banka vlerëson shumë faktorë të ndryshëm, mes tjerash edhe lëkundjen normale të çmimit të aksioneve. Përveç kësaj, rënia në vlerë mund të jetë e mundshme kur ka dëshmi të dëmtimit të gjendjes financiare të përfituesit të investimit, industrisë të cilës i përket ai apo sektorit përkatës, ndryshime në teknologji dhe rrjedhë të parave që shfrytëzohen për qëllime operative apo financiare.

c) Rënia në vlerë e pasurive të sekuestruara

Procesi i kalkulimit të humbjeve nga rënia në vlerë kërkon nga menaxhmenti dhënien e disa parashikimeve të rëndësishme dhe komplekse lidhur me shitjen e pasurive të sekuestruara, vlerën neto të shitjes së tyre dhe normën korresponduese të zbritjes, në mënyrë që të arrihet deri tek vlera aktuale neto e cila do t'i shtohet rrjedhës së parave nga shitja e pronave të sekuestruara.

Menaxhmenti i Bankës beson se pasuritë e sekuestruara do të shiten brenda një kornize kohore të arsyeshme, pa humbje.

d) Lëkundjet e fundit në tregjet financiare globale

Kriza e paprecedent në tregjet financiare ndërkombëtare, gjatë viteve 2012 dhe 2011, kishte ndikim të vogël në sektorin financiar të Kosovës, pasi që ai nuk preket shumë nga sektori financiar ndërkombëtar. Ekspozimi në kuptim të letrave me vlerë ishte i limituar tek shtetet e OECD-së me rangim AAA. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të kryejë veprimtarinë e vet normale duke u bazuar në huadhënien në ekonominë vendore, ndërsa burimi kryesor i financave vazhdojnë të jenë depozitat brenda Kosovës.

4. Menaxhimi i riskut financiar

4.1 Pasqyrë e përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve vijuese që rrjedhin nga shfrytëzimi i instrumenteve financiare:

- Risku kreditor
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut
- Risku operativ

Ky shënim paraqet informatat mbi eksponimin e bankës ndaj kategorive të ndryshme të riskut të përmendura më sipër, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e saj për matjen dhe menaxhimin e riskut, si dhe mbi mënyrat e menaxhimit të kapitalit nga ajo.

Korniza e menaxhimit të riskut

Kontrollet e brendshme dhe mjetet e kontrollit shtesë të riskut të përcaktuara nga sistemi i Menaxhimit të Riskut të Raiffeisen International mundësojnë menaxhim të kontrolluar të riskut në tërë Bankën. Veglat për menaxhimin e riskut dhe kontrollimin e riskut janë përcaktuar në pajtueshmëri me njohuritë më të fundit mbi menaxhimin e riskut. Veglat e menaxhimit të riskut janë miratuar nga Raiffeisen Bank International AG dhe shfrytëzohen nga Banka.

Nga janari i vitit 2008, Banka ka vepruar në pajtueshmëri me kërkesat e Basel II dhe raporton në bazë të tyre në nivel të grupit, përfshirë këtu edhe riskun kreditor dhe të tregut. Deri tani është aplikuar një qasje e standardizuar. Transformimi në qasjen më të fundit është në fazën e zhvillimit. Implementimi i kërkesave të Basel II do duhej të sigurojë menaxhim më të mirë të kapitalit.

Mjedisi i thjeshtë financiar dhe i tregut në Kosovë mundëson përdorimin e metodës së analizës së thjeshtë. Faktorët më kompleks që e presin industrinë bankare në të ardhmen do të përkrahen me sajimin e metodave të reja për t'i menaxhuar ato më mirë.

Bazuar në politikat e Bankës, pasuritë e përgjithshme të Bankës klasifikohen dhe analizohen si në vijim:

- Analiza e pasurive në bazë të klasës së asetit/produktit (pasuritë klasifikohen në bazë të katalogut të produkteve të grupit);
- Analiza e pasurive në bazë të cilësisë kreditore (pasuritë klasifikohen në bazë të direktivave të grupit);
- Analiza e pasurive në pajtim me bazën e matjes;
- Analiza e pasurive në bazë të vjetërsisë, që nënkupton kryerjen e analizës për pasuri të cilat janë në vonesë por nuk janë të rëna në vlerë;
- Analiza individuale e pasurive të përcaktuara si të rëna në vlerë, në bazë të faktorëve të dëmtimit;
- Analiza e pasurive në bazë të llojit të pengut dhe duke shqyrtuar vlerën e kthimit të parashikuar;
- Analiza e pasurive në bazë të koncentrimin të riskut për industri/sector/segment/vlerë të caktuar të ekspozimit.

4.2. Risku kreditor

Risku kreditor është risku nga humbja financiare e Bankës nëse një klient apo palë homologe e një instrumenti financiar nuk arrin t'i përmbushë obligimet e veta kontraktuale, i cili shfaqet kryesisht tek kreditë dhe paradhëniet të Bankës për klientët e vet dhe bankat tjera, si dhe tek investimet në letra me vlerë. Për qëllime të raportimit të riskut kreditor, Banka i shtjellon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (siç janë risku i rënies në vlerë të të detyruarit, risku në nivel shteti apo në nivel sektori).

Banka është e ekspozuar ndaj riskut kreditor, që përbën riskun se një palë homologe nuk do të jetë në gjendje të paguajë të gjitha shumat në kohën kur ato duhet paguar. Banka e strukturon nivelin e riskut që merr përsipër duke vendosur kufijtë mbi vlerat e riskut që i pranon kundrejt një huamarrësi, një industrie apo një zone gjeografike. Këto lloje të riskut monitorohen në baza të përhershme dhe rishikohen çdo muaj ose më shpesh. Kufijtë e nivelit të riskut kreditor për huamarrës miratohen nga Menaxhmenti.

Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet përmes analizave të rregullta të aftësisë së huamarrësve dhe huamarrësve potencialë për të kryer obligimet në kuptim të pagimit të interesive dhe kryegjësë, dhe duke i ndryshuar këto limite sipas nevojës. Ekspozimi ndaj riskut kreditor gjithashtu menaxhohet, pjesërisht, duke marrë pengje dhe garanci korporative dhe personale.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj riskut kreditor parimisht pasqyrohet duke i bartur shumat e pasurive financiare në pasqyrat e gjendjes financiare. Ndikimi i rrjetëzimit të mundshëm të pasurive dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin potencial kreditor nuk është i rëndësishëm.

Risku kreditor për instrumentet financiare që nuk gjenden në bilancin e gjendjes definohet si mundësia për tu përballur me humbje që vijnë si rezultat i rënies në vlerë të ndonjë pale tjetër të instrumentit financiar, në pajtim me afatet e kontratës. Banka shfrytëzon të njëjtat politika kreditore gjatë hyrjes në obligime tjera sikur edhe për instrumentet financiare në bilancin e gjendjes, përmes procedurave për miratimin e kredive, limiteve për kontrollim dhe monitorim të riskut, etj.

Banka mban lloje të ndryshme të pengut për tu siguruar ndaj riskut kreditor. Përveç kësaj, shfrytëzohen edhe metoda tjera për fuqizimin e kredive. Llojet kryesore të pengut janë listuar në vijim:

- Pronat (toka, shtëpi)
- Banesat
- Veturat
- Pajisjet
- Garancitë personale

Kreditë dhe garancitë e rëna në vlerë

Kreditë dhe garancitë e rëna në vlerë janë kredi dhe garanci për të cilat Banka vlerëson se ka gjasa që të mos jetë në gjendje të inkasojë të gjitha pagesat e kryegjësë dhe interesit, në pajtim me kushtet dhe afatet e kredisë/garancisë. Këto kredi vlerësohen me notë prej 0.5 deri 5 në sistemin e brendshëm të rangimit të kredive të Bankës.

Kreditë me vonesa por jo të rëna në vlerë

Në këtë kategori bien kreditë në të cilat pagesat e interesit apo kryegjësë janë në vonesë, por Banka beson se sipas nivelit të garancive që i janë ofruar/pengut në dispozicion/gjendjes së grumbullimit të vlerave që i detyrohen Bankës.

Kreditë me kushte të rinegociuara

Kreditë me kushte të rinegociuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes së huamarrësit dhe në rastet kur Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i bënte në kushte tjera. Pasi ristrukturimit të kredisë, ajo mbetet në këtë kategori, pa marrë parasysh nëse pas ristrukturimit të saj kthimi ka qenë i kënaqshëm.

Rezervat për rënie në vlerë

Banka themelon një llogari kompensuese për humbje nga dështimet, e cila paraqet parashikimet e humbjeve në portfolion e kredive. Komponentët kryesor të kësaj llogarie janë komponenti i humbjeve specifike që ndërlidhen me ekspozimet individuale, dhe llogaria kompensuese kolektive për kreditë e cila themelohet për grupe të pasurive homogjene në aspekt të humbjeve që janë përllogaritur por që ende nuk janë identifikuar për kreditë të cilat i nënshtrohen vlerësimit individual.

Politikat e shlyerjes së kredive

Banka i shlyen mbetjet e kredisë (dhe të gjitha llogaritë kompensuese për humbje nga dështimi) kur Komisioni i Bankës për Kredi Problematike vlerëson se kredia/garancitë nuk mund të kthehen. Ky vlerësim bëhet pasi që të shqyrtohen informata siç janë ndryshimi i pozitës financiare të huamarrësit, që bën që ai të mos jetë në gjendje t'i paguajë më obligimet e veta, apo se nga shitja e pengut nuk do të grumbullohen mjaft mjete për ta mbuluar tërë ekspozimin.

Në vijim është ofruar një analizë e pasurive financiare me vonesa por jo të rëna në vlerë, si dhe pasuritë e rëna në vlerë:

(vlerat në € 000)	Gjithsejt shuma bruto	Pasuri me vonesë por jo të rëna në vlerë	Pasuri individuale të rëna në vlerë (gjithsej shuma)	Provizione për humbje kreditore individuale	Provizione për humbje kreditore për portfolio	Vlera reale e pengut
2012						
Klientë korporata	244,160	75,385	25,968	(11,624)	(6,200)	251,714
Klientë retail	183,322	14,298	8,546	(6,928)	(1,663)	173,486
Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët	427,482	89,683	34,514	(18,552)	(7,863)	425,200
2011						
Klientë korporata	242,484	48,313	29,952	(11,883)	(6,334)	248,446
Klientë retail	186,592	13,657	7,304	(7,391)	(1,358)	175,707
Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët	429,076	61,970	37,256	(19,274)	(7,692)	424,153

Në vijim është paraqitur analiza e jetëgjatësisë së kredive dhe paradhënieve të vonuara dhe të rëna në vlerë dhe të vonuara por jo të rëna në vlerë:

2012	Më pak se një muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Gjithsej
Kredi dhe paradhënie tek klientët që janë vonuar por nuk janë të rëna në vlerë	9,131	18,390	15,309	46,853	89,683
Kredi dhe paradhënie tek klientët që janë vonuar dhe kanë rënë në vlerë	15,988	1,372	5,409	11,745	34,514
2011	Më pak se një muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Gjithsej
Kredi dhe paradhënie tek klientët që janë vonuar por nuk janë të rëna në vlerë	4,494	9,371	18,050	30,055	61,970
Kredi dhe paradhënie tek klientët që janë vonuar dhe kanë rënë në vlerë	13,980	1,433	2,939	18,904	37,256

Banka monitoron përqendrimin e riskut kreditor sipas sektorit. Në vijim është paraqitur analiza e koncentrimit të riskut kreditor në datat 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011:

2012	Më pak se një muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Gjithsej
Klientë korporata	14,270	1,198	3,007	7,492	25,967
Klientë retail	1,718	174	2,402	4,253	8,547
Gjithsej kredi dhe paradhënie të rëna në vlerë	15,988	1,372	5,409	11,745	34,514
2011	Më pak se një muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Gjithsej
Klientë korporata	12,397	1,280	2,087	14,188	29,952
Klientë retail	1,583	153	852	4,717	7,305
Gjithsej kredi dhe paradhënie të rëna në vlerë	13,980	1,433	2,939	18,905	37,257

4.3 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka të përballlet me vështirësi në përmbushjen e obligimeve të veta për shkak të detyrimeve të veta financiare. Banka pranon thirrje ditore lidhur me burimet e veta në para të gatshme në llogaritë rrjedhëse, depozitat në maturim, kreditë e tërhequra dhe garancitë. Risku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës.

Banka mban pasuri afatmesme deri afatgjata dhe, për shkak të rrethanave të tregut, e financon portfolion e vet me huazime afatshkurtra. Gjatë këtij procesi, Banka merr përsipër riskun e likuiditetit që ndërlidhet me mospërputhjen e periudhave të maturimit. Risku i menaxhuar në mënyrë të duhur është i pranueshëm. Është e pazakonshe për bankën që të barazojë maturimet. Banka lëshon pasuri afatgjata, siç janë kreditë për klientë individualë dhe hipotekat, dhe këto portfolio kryesisht financohen përmes depozitave të hapura dhe depozitave të afatizuara deri në një vit. Menaxhmentit i parashtrohen çdo ditë informata mbi normën e likuiditetit të Bankës, si dhe raporti javor i likuiditetit në të cilin të dhënat ndahen sipas segmentit afarist. Pasi që Banka lëshon pasuri afatmesme deri afatgjata, e të njëjtit i financon me huazime afatmesme, ajo nuk i ekspozonhet riskut nga lëkundja e normave të interesit.

Tabela në vijim paraqet pasuritë dhe detyrimet në datat 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011, të ndara sipas kohëzgjatjes së maturimit të tyre. Megjithatë, disa nga pasuritë mund të jenë për nga natyra më afatgjata; për shembull, kreditë shpesh ripërtërihen dhe kjo bën që kreditë që janë afatshkurtra të shndërrohen në afatgjata.

	Më pak se 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Të pa- specifikuara	Gjithsej
Pasuri						
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	12,668	-	-	-	73,550	86,218
Huatë për bankat tjera	46,103	-	-	-	-	46,103
Kredi dhe paradhënie për klientë	35,785	58,521	128,461	178,299	-	401,066
Kredi tjera	533	-	1,753	18,588	-	20,873
Investime në letra me vlerë	17,338	17,270	4,216	25,277	-	64,102
Pasuri tjera	-	-	270	-	-	270
Gjithsej pasuri financiare	112,427	75,791	134,700	222,164	73,550	618,632
Detyrime						
Depozita nga klientët	366,590	23,205	104,151	19,923	-	513,869
Depozita dhe huazime nga bankat	522	-	2,600	1,091	-	4,213
Detyrime tjera	-	-	7,869	-	-	7,869
Gjithsej detyrime financiare	367,112	23,205	114,620	21,014	-	525,951
Neto dallimi më 31 dhjetor 2012	(254,685)	52,586	20,080	201,150	73,550	92,681

	Më pak se 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Të pa- specifikuara	Gjithsej
Pasuri						
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	13,464	-	-	-	76,901	90,365
Huatë për bankat tjera	85,910	-	-	-	-	85,910
Kredi dhe paradhënie për klientë	46,351	43,788	132,586	179,385	-	402,110
Kredi tjera	508	-	3,821	26,591	-	30,920
Investime në letra me vlerë	-	947	22,330	39,154	442	62,873
Pasuri tjera	-	-	340	-	-	340
Gjithsej pasuri financiare	146,233	44,735	159,077	245,130	77,343	672,518
Detyrime						
Depozita nga klientët	449,133	20,571	77,749	9,823	-	557,277
Depozita dhe huazime nga bankat	103	90	4,155	8,336	-	12,684
Detyrime tjera	-	-	11,246	-	-	11,246
Gjithsej detyrime financiare	449,236	20,661	93,150	18,159	-	581,207
Neto dallimi më 31 dhjetor 2011	(303,003)	24,074	65,926	226,971	77,343	91,311

Analiza e maturimit të kredive të klientëve bazohet në datat e përkohshme të përcaktuara për mbetjen e kohës deri në maturim në kontratat e kredive, do të thotë duke marrë parasysh ratat që duhet paguar në baza mujore.

Mënyrat që përdoren aktualisht për të menaxhuar dhe kufizuar riskun afarist në Bankë janë raportet e likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit afarist, monitorimi i normës së palëvizshmërisë për të gjitha segmentet afariste, limitet dhe raportet kontabile që matin riskun e interesit dhe boshllëqet.

Pasuritë në vonesë janë të mbuluara plotësisht dhe si të tilla nuk kanë ndikim në tabelat e mësipërme. Rezervat e domosdoshme të likuiditetit janë të përfshira në kategorinë e vonesave deri një muaj, pasi që shumica e detyrimeve që ndërliken me këtë bilanc gjithashtu përfshihen në këtë kategori.

Analiza e maturimit të detyrimeve financiare është analizuar në vijim:

- Bazuar në datën më të hershme të maturimit kontraktual – skenari më i pavolitshtëm;
- Bazuar në rrjedhat e kontraktuara dhe të pazbritura të parasë;
- Duke përcaktuar afatet kohore;
- Rrjedhat e pritura të parave janë përdorur si informata shtesë.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar mes maturimit dhe normave të interesit të pasurive dhe detyrimeve është e një rëndësie thelbësore për Bankën. Për bankat është e pazakontë që të jenë në përputhje të plotë, pasi që transaksionet afariste janë të llojeve të ndryshme dhe shpesh me afate ta papërcaktuara. Maturimi i pasurive dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar me një kosto të pranueshme detyrimet e bankës që bartin interes pas maturimit të tyre, përbëjnë faktorë të rëndësishëm për vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimit të saj ndaj ndryshimeve në norma të interesit dhe të këmbimit valutor.

Banka ka një mospërputhje të theksuar të pasurive dhe detyrimeve që maturohen brenda një viti. Kjo mospërputhje e likuiditetit rrjedh nga fakti se burimi kryesor financiar i Bankës më 31 dhjetor 2012 ishin llogaritë e klientëve që ishin të hapura ose që maturoheshin brenda më pak se një muaji. Menaxhmenti beson se përkundër faktit që një pjesë e madhe e klientëve kishin llogari të hapura, diversiteti i këtyre depozitave, në kuptim të numrit dhe tipit të depozituesve, ishin indikacion se llogaritë e këtyre klientëve ofrojnë një burim afatgjatë dhe stabil të financimit për bankën.

Banka e ka përmirësuar pozitën e vet neto, përmes burimeve tjera të financimit, të cilat ofrojnë financim afatmesëm, si dhe mëton të vazhdojë përputhjen mes maturimit të pasurive dhe detyrimeve në të ardhmen. Përveç kësaj, Banka ka Marrëveshje për Mjete Kreditorë të cilën nuk e ka shfrytëzuar e të cilën do ta shfrytëzojë në rast të shfaqjes së nevojës për likuiditet.

Shuma e përgjithshme e zotimeve të mbetura për zgjatjen e kredisë nuk paraqet domosdoshmërisht kërkesën e ardhshme për para të gatshme, pasi që shumë nga zotimet e tilla do të skadojnë apo shkëputen pa u financuar fare.

4.4 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e një investimi do të bie për shkak të lëvizjes së faktorëve të tregut. Katër faktorët standardë të riskut të tregut janë:

- Risku i kapitalit apo risku i ndryshimit të çmimeve të aksioneve.
- Risku i interesit apo risku i ndryshimit të normave të interesit.
- Risku valutor apo risku i ndryshimit të kursit të këmbimit të valutave të huaja.
- Risku i produkteve bazike apo risku i ndryshimit të çmimit të produkteve bazike (d.m.th. drithërave, metaleve, etj.).

Banka përballlet me risk të tregut. Risku i tregut shfaqet nga pozicionet e hapura në kuptim të normës së interesit dhe produkteve në valuta të huaja, të cilat i ekspozohen lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti përcakton limitet e riskut që është i pranueshëm, i cili monitorohet në baza ditore. Megjithatë, shfrytëzimi i kësaj qasjeje nuk parandalon humbjet që mund të shfaqen jashtë limiteve të tilla në rast të lëvizjeve më të mëdha në treg.

Risku gjeografik

Në vijim është paraqitur përqendrimi gjeografik i pasurive dhe detyrimeve të Bankës më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011:

	Kosovë	BE	Tjera	Gjithsej
Pasuri				
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	73,549	9,686	2,983	86,218
Huatë për bankat tjera	-	46,103	-	46,103
Kredi dhe paradhënie për klientë	401,066	-	-	401,066
Kredi tjera	-	20,873	-	20,873
Investime në letra me vlerë	5,988	41,497	16,617	64,102
Pasuri tjera	270	-	-	270
Gjithsej pasuri financiare	480,873	118,159	19,600	618,632
Detyrime				
Depozita nga klientët	482,641	12,412	18,816	513,869
Depozita nga bankat	201	3,913	99	4,213
Detyrime tjera	4,429	3,440	-	7,869
Gjithsej detyrime financiare	487,271	19,765	18,915	525,951
Neto dallimi më 31 dhjetor 2012	(6,398)	98,394	685	92,681

	Kosovë	BE	Tjera	Gjithsej
Pasuri				
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	76,901	10,215	3,249	90,365
Huatë për bankat tjera	-	81,428	4,482	85,910
Kredi dhe paradhënie për klientë	402,110	-	-	402,110
Kredi tjera	-	22,118	8,802	30,920
Investime në letra me vlerë	-	53,698	9,175	62,873
Pasuri tjera	340	-	-	340
Gjithsej pasuri financiare	479,351	167,459	25,708	672,518
Detyrime				
Depozita nga klientët	535,911	7,821	13,545	557,277
Depozita nga bankat	98	11,382	1,204	12,684
Detyrime tjera	8,541	2,705	-	11,246
Gjithsej detyrime financiare	544,550	21,908	14,749	581,207
Neto dallimi më 31 dhjetor 2011	(65,199)	145,551	10,959	91,311

Risku valutor

Kjo formë e riskut rrjedh nga ndryshimi i vlerës së një valute kundrejt një valute tjetër. Risku valutor menaxhohet përmes monitorimit të pozicioneve në bursat e hapura ndërkombëtar. Këto pozicione përcaktohen ndaras për ditë dhe për natë. Analiza e ndjeshmërisë i sigurohet menaxhmentit në baza javore.

Banka është e ekspozuar ndaj efekteve të lëkundjes të kursit të këmbimit të valutave të huaja në pozitën financiare dhe rrjedhën e parasë së saj. Menaxhmenti përcakton limitet e nivelit të ekspozimit sipas valutës dhe ekspozimit të gjithmbarshëm, të cilat monitorohen në baza ditore. Shfrytëzimi i valutës euro në Kosovë dhe ekspozimi i limituar ndaj valutave tjera sjellin si rezultat nevojën e kufizuar për të shfrytëzuar derivate.

Raporti i Riskut të Tregut, që përfshin Raportin e Riskut nga Normat e Interesit dhe raportin e këmbimit valutor nga Open FX, i dërgohet menaxhmentit për çdo javë. Raporti përkatës përgatitet nga menaxhmenti i riskut i RZB Vienna, në bazë të inpueteve të cilat i jepen nga burimet lokale të raportimit.

Në tabelën në vijim janë përmbledhur nivelet e ekspozimit të Bankës ndaj riskut të vlerës së këmbimit të valutave të huaja më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011. Në tabelë përfshihen edhe pasuritë dhe detyrimet e Bankës, sipas vlerave aktuale, të kategorizuara sipas valutës.

	EUR	USD	Tjera	Gjithsej
Pasuri				
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	72,458	4,744	9,016	86,218
Huatë për bankat tjera	36,500	7,767	1,836	46,103
Kredi dhe paradhënie për klientë	401,066	-	-	401,066
Kredi tjera	20,873	-	-	20,873
Investime në letra me vlerë	47,485	16,617	-	64,102
Pasuri tjera	270	-	-	270
Gjithsej pasuri financiare	578,652	29,128	10,852	618,632
Detyrime				
Depozita nga klientët	469,321	29,150	15,398	513,869
Depozita nga bankat	4,211	1	1	4,213
Detyrime tjera	7,869	-	-	7,869
Gjithsej detyrime financiare	481,401	29,151	15,399	525,951
Neto dallimi më 31 dhjetor 2012	97,251	(23)	(4,547)	92,681

	EUR	USD	Tjera	Gjithsej
Pasuri				
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	76,605	4,744	9,016	90,365
Huatë për bankat tjera	64,002	20,710	1,198	85,910
Kredi dhe paradhënie për klientë	402,110	-	-	402,110
Kredi tjera	30,920	-	-	30,920
Investime në letra me vlerë	53,698	9,175	-	62,873
Pasuri tjera	340	-	-	340
Gjithsej pasuri financiare	627,675	34,629	10,214	672,518
Detyrime				
Depozita nga klientët	509,068	35,451	12,758	557,277
Depozita nga bankat	12,682	1	1	12,684
Detyrime tjera	11,246	-	-	11,246
Gjithsej detyrime financiare	532,996	35,452	12,759	581,207
Neto dallimi më 31 dhjetor 2011	94,679	(823)	(2,545)	91,311

Analiza e ndjeshmërisë së valutave të huaja

Valutat e huaja ndaj të cilave Banka është kryesisht e ekspozuar janë dollari amerikan (USD), franka zvicerane (CHF) dhe funta britanike (GBP). Në tabelën vijuese paraqitet ndjeshmëria e Bankës ndaj rritjes apo rënies së vlerës së euros kundrejt valutave të huaja. Përqindja e shfrytëzuar është norma e ndjeshmërisë që shfrytëzohet gjatë raportimit të riskut valutor tek stafi menaxherial dhe paraqet vlerësimin e menaxhmentit lidhur me ndryshimin e mundshëm të normave të këmbimit valutor. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm njësitë monetare të mbetura në valutë të huaj dhe kthen normat gjegjëse në fund të periudhës së raportimit për të paraqitur dallimin në normat e këmbimit të valutave të huaja. Kjo analizë e ndjeshmërisë përfshin plasmanin në bankat tjera, paratë e gatshme në bankat korrespondente si dhe depozitat e klientëve në rast kur shumata e depozituar janë në valuta të ndryshme nga valuta e huadhënësit apo huamarrësit. Numri pozitiv në vijim dëshmon rritje të fitimit dhe kapitalit tjetër në rast kur euro fuqizohet për përqindjet përkatëse ndaj valutës gjegjëse. Dobësimi i euros kundrejt valutës përkatëse, do të kishte ndikim përafërsisht të njëjtë në anën tjetër në fitim dhe kapitalin tjetër, ndërsa bilanci i mëposhtëm do të ishte negativ.

	Dollarë të SHBA-ve (USD)		Franka zvicerane (CHF)		Funte britanike (GBP)	
	2012	2011	2012	2011	2012	2011
Norma e ndjeshmërisë	7%	10%	1%	14%	3%	4%
Fitim dhe humbje	(5)	(35)	1,133	(2)	(89)	(9)

Sipas vlerësimit të menaxhmentit, analiza e ndjeshmërisë nuk përfaqëson si duhet riskun e bartur nga këmbimi valutor, pasi që ekspozimi në fund të vitit nuk pasqyron ekspozimin gjatë vitit. Transaksionet në dollarë amerikan, franka zvicerane dhe funte britanike nuk janë të shpeshta dhe bëhen vetëm për transaksione dhe plasman në institucionet financiare jashtë BE-së.

Risku nga norma e interesit

Ky është risku se vlera relative e një aseti që bartë interes do të shënojë rënie. Pasuritë e Bankës kryesisht përbëhen nga kredi afatmesme deri afatgjata, ndërsa detyrimet janë kryesisht depozita afatshkurtra, kështu që ato Bankën e ekspozojnë ndaj mospërputhjes së normave të interesit dhe rrjedhimisht kjo mospërputhje bën që Banka t'i ekspozohet riskut të lëkundjes së normave të interesit në treg.

Banka është e ekspozuar ndaj efekteve të lëkundjeve të nivelit të përgjithshëm të normave të interesit në treg, të cilat ndikojnë në pozitën financiare dhe rrjedhën e parasë së saj. Margjinat e interesit mund të shtohen si rezultat i ndryshimeve në fjalë, por lëvizjet e papritura mund të shkaktojnë zvogëlim apo shtim të humbjeve.

Banka është e ekspozuar ndaj riskut të normave të interesit, kryesisht si rezultat i huamarrjes me norma jofikse të interesit, edhe në kuptim të shumave edhe në kuptim të kohëzgjatjes, të cilat dallojnë nga depozitat e afatizuara që kanë afate dhe norma të interesit të parapërcaktuara. Në praktikë, normat e interesit zakonisht përcaktohen në bazë afatshkurtra. Menaxhmenti i përcakton kufijtë e nivelit të mospërputhjes mes çmimeve të normave të interesit që guxon të lejohet. Sipas kontratave për shkëmbimin e normave të interesit, Banka pajtohet të këmbëjë dallimin mes shumave të normës të interesit fikse dhe asaj të luajtshme që kalkullohet sipas vlerave të pajtuara joreale. Paratë e gatshme dhe bilanci me BQK-në për të cilat nuk paguhet interes janë përfshirë në kolonën e tabelës së mëposhtme të emërtuar 'jobartëse të interesit'. Në të njëjtën kolonë përfshihen edhe depozitat e klientëve pa interes.

Për të mbuluar boshllëkun e kredive afatmesme deri afatgjata kundrejt huave të ndryshme afatshkurtra deri afatmesme, shfrytëzohet derivati financiar i quajtur Shkëmbimi i Normës së Interesit, në të cilin Banka Raiffeisen në Kosovë mbetet kryesisht pagues i interesit fiks, ndërsa pala tjetër mbetet paguesi i normës së interesit të ndryshueshme, ndërsa kjo e fundit për të siguruar ndjeshmëri optimale është e indeksuar si EURIBOR-i i 6 muajve.

Banka Raiffeisen në Kosovë aplikon menaxhim aktiv të riskut për tu mbrojtur nga risku i tregut. Risku i normës së interesit evitohet përmes derivateve financiare. Për të siguruar veprimtari fitimprurëse afatgjatë nga portfoliot ekzistuese të kredive, me maturim nga viti 2013 e deri në 15 vite, këto pozicione mbulohehen përmes Shkëmbimeve të Normës së Interesit. Pozicionet deri në 5 vite mbrohen në masë prej 75 për qind, ndërsa pozicionet mes 5-10 vjet me normë 100 për qind. Kjo qasje e kontrollimit të riskut siguron VaR (vlerë të rrezikuar) optimal.

Tabela e mëposhtme përmbledh eksponimin e Bankës ndaj riskut nga norma e interesit. Në këtë tabelë përfshihen pasuritë dhe detyrimet e bankës, sipas vlerave aktuale, të kategorizuara sipas datave paraprake të maturimit dhe çmimeve kontraktuale të ndryshuara.

	Më pak se një muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Nuk bartin interes	Gjithsej
Pasuri						
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	12,668	-	-	-	73,550	86,218
Huatë për bankat tjera	45,755	-	-	-	348	46,103
Kredi dhe paradhënie për klientë	35,785	58,521	128,461	178,299	-	401,066
Kredi tjera	532	-	1,753	18,588	-	20,873
Investime në letra me vlerë	17,339	17,270	4,216	25,277	-	64,102
Pasuri tjera	-	-	-	-	270	270
Gjithsej pasuri financiare	112,079	75,791	134,430	222,164	74,168	618,632
Detyrime						
Depozita nga klientët	155,952	23,205	104,151	19,923	210,638	513,869
Depozita nga bankat	37	-	2,600	1,091	485	4,213
Detyrime tjera	-	-	-	-	7,869	7,869
Gjithsej detyrime financiare	155,989	23,205	106,751	21,014	218,992	525,951
Neto dallimi më 31 dhjetor 2012	(43,910)	52,586	27,679	201,150	(144,824)	92,681

	Më pak se një muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Mbi 12 muaj	Nuk bartin interes	Gjithsej
Pasuri						
Para të gatshme dhe ekuivalente të tyre dhe rezerva e domosdoshme për likuidet	13,464	-	-	-	76,901	90,365
Huatë për bankat tjera	85,556	0	-	-	354	85,910
Kredi dhe paradhënie për klientë	46,351	43,788	132,586	179,385	-	402,110
Kredi tjera	508	-	3,821	26,591	-	30,920
Investime në letra me vlerë	-	947	22,330	39,154	442	62,873
Pasuri tjera	-	-	-	-	340	340
Gjithsej pasuri financiare	145,879	44,735	158,737	245,130	78,037	672,518
Detyrime						
Depozita nga klientët	205,371	20,572	77,749	9,823	243,762	557,277
Depozita nga bankat	82	90	4,155	8,336	21	12,684
Detyrime tjera	-	-	-	-	11,246	11,246
Gjithsej detyrime financiare	205,453	20,662	81,904	18,159	255,029	581,207
Neto dallimi më 31 dhjetor 2011	(59,574)	24,073	76,833	226,971	(176,992)	91,311

Tabela e mëposhtme përmbledh normat e interesit të zbatueshme për valutat kryesore në instrumentet kryesore monetare. Analiza është përgatitur duke shfrytëzuar normat efektive vjetore.

Në përqindje	2012				2011			
	EUR	USD	CHF	GBP	EUR	USD	CHF	GBP
Pasuri								
Plasman në banka tjera, të shfrytëzueshme sipas nevojës	0.1	0.2	0.0	0.4	0.7	0.1	0.0	0.4
Depozita të afatizuara në banka tjera	0.1	0.2	N/A	0.4	0.9	0.2	N/A	N/A
Bono qeveritare me rendiment HTM	1.8	1.1	N/A	N/A	1.6	1.4	N/A	N/A
Bono qeveritare me rendiment AFV	2.5	0.1	N/A	N/A	1.2	N/A	N/A	N/A
Kredi dhe paradhënie tek klientët	10.7	N/A	N/A	N/A	11.1	N/A	N/A	N/A
Kredi tjera	2.3	N/A	N/A	N/A	1.6	N/A	N/A	N/A
Detyrime								
Llogari të klientëve	0.4	0.0	0.0	0.0	0.7	0.0	0.0	0.0
Depozita të afatizuara	3.8	1.2	1.0	1.0	4.5	1.3	1.0	1.0
Llogari kursimi	2.2	0.3	0.3	0.3	2.3	0.3	0.3	0.3

Nga perspektiva e menaxhimit të riskut dhe kontrollit ekzistojnë dy aspekte të riskut:

- Vlerësimi i riskut
- Kontrolli i riskut

Vlerësimi i riskut të interesit

Risku nga normat e interesit matet duke shfrytëzuar qasjen VaR (vlerën e rrezikuar). Kjo qasje nënkupton një matje të skenarit, duke shfrytëzuar kohëzgjatjen prej 10 ditësh dhe intervalin e besueshmërisë prej 99 për qind. VaR matet nën ndikim prej 1bps në lakoren e rendimentit. Ky skenar supozon implikimin në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve të Bankës, në rast se lakorja e rendimentit lëviz në njërin apo tjetrin anë për një pikë të përqindjes, apo 0.01 për qind. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë i paraqiten menaxhmentit për çdo javë, dhe i dërgohen në mënyrë të pavarur Menaxhmentit të Riskut të RZB Vienna.

Kontrolli i riskut të normës së interesit

Mekanizmi për kontrollin e riskut të normës së interesit shfrytëzohet përmes raporteve ditore të Vlerës së Pikëve të Përqindjes (BPV). Banka aktualisht posedon limit BPV prej 55 mijë euro. Për qëllime të matjes së BPV-së, produktet me normë të administruar modelohen duke shfrytëzuar portfolio të replikimit. Vlera e Pikëve të Përqindjes matet për valutë dhe për periudhë kohore. Limitet përcaktohen edhe për valutë edhe për periudha kohore të ndryshme.

4.5 Risku operativ

Përgjegjësia primare për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve me të cilët adresohet risku operativ bartet nga menaxhmenti i lartë i secilës njësi afariste. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e riskut operativ në fushat vijuese:

- Kërkesat për ndarje adekuate të detyrave, përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve
- Kërkesat për barazim dhe monitorim të transaksioneve
- Pajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe kërkesat tjera ligjore
- Dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- Kërkesat për vlerësim periodik të riskut operativ të hasur dhe të adekuacisë së kontrolleve dhe procedurave të parapara për të adresuar riskun
- Kërkesat për raportim të humbjeve operative dhe të veprimeve të propozuara për rregullim të gjendjes
- Sajimi i planeve emergjente
- Trajnimi dhe zhvillimi profesional
- Etika dhe standardet afariste
- Evitimi i riskut, përfshirë sigurimin kurdo që kjo ka efekt.

